FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.77 14 qershor 2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 424 datë 2.6.2011	Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës "Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës"	3123
Ligj nr.10 425 datë 2.6.2011	Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës "Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve"	3126
Ligj nr.10 426 datë 2.6.2011	Për ratifikimin e protokollit të tretë shtesë të konventës e uropiane "Për ekstradimin"	3134
Ligj nr.10 427 datë 2.6.2011	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse për përmbushjen e detyrimeve financiare të Republikës së Shqipërisë kundrejt Federatës Ruse për balancat e llogarive të korporatës shtetërore "Banka e Zhvillimit dhe Veprimtarisë Ekonomike me Jashtë (Vneshekonombank)" te Banka e Shtetit Shqiptar".....	3139
Rezolutë e Kuvendit datë 2.6.2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2010	3141
Rezolutë e Kuvendit datë 2.6.2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Prokurimeve për vitin 2010	3142
Rezolutë e Kuvendit datë 2.6.2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2010	3143
Rezolutë e Kuvendit datë 2.6.2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2010	3144

Udhëzim i MF, METE dhe AKKP nr.10, datë 12.5.2011	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.804, datë 22.7.2009 "Për përcaktimin e çmimit të trojeve në zonat industriale, ku ushtrohen veprimtari ekonomiko-industriale, në objektet e ndërtuara mbi këto troje".....	3145
Udhëzim i MB nr.254, datë 10.6.2011	Për konstituimin e organeve të qeverisjes vendore	3146
Vendim i GJK nr.19, datë 1.6.2011	Me objekt shfuqizimin e paragrafëve VII dhe VIII të nenit 34 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.....	3149
Vendim i BSH nr.39, datë 25.5. 2011	Për miratimin e rregullores "Për eksport–importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike shqiptare"	3157

LIGJ
Nr.10 424, datë 2.6.2011

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS "PËR STATUSIN JURIDIK TË FËMIJËVE TË LINDUR JASHTË MARTESËS"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e Këshillit të Europës "Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7013, datë 13.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA EUROPIANE
MBI STATUSIN LIGJOR TË FËMIJËVE
TË LINDUR JASHTË MARTESE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të saj,

duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti sa më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, në veçanti me miratimin e rregullave të përbashkëta në fushën e ligjit;

duke vënë re se në një numër të madh të shteteve anëtare janë bërë ose po bëhen përpjekje për të përmirësuar statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martese, duke zvogëluar dallimet ndërmjet statusit të tyre ligjor dhe atij të fëmijëve të lindur në martesë të cilat janë në disavantazh juridik ose social të të parëve;

duke njohur se ende ekzistojnë mospërputhje të mëdha në ligjet e shteteve anëtare në këtë fushë;

duke besuar se situata e fëmijëve të lindur jashtë martese duhet të përmirësohet dhe se hartimi i disa rregullave të përbashkëta në lidhje me statusin e tyre ligjor do të ndihmojë këtë objektiv dhe në të njëjtën kohë do të kontribuojë për një harmonizim të ligjeve të shteteve anëtare në këtë fushë;

megjithatë, *duke pasur* parasysh se është e nevojshme të pranohen etapa progresive për ato shtete të cilat nuk e konsiderojnë veten në gjendje të miratojnë menjëherë disa rregulla të kësaj konvente;

kanë rëndë dakord si më poshtë:

Neni 1

Çdo palë kontraktuese merr përsipër të sigurojë përputhshmërinë e ligjit të saj me dispozitat e kësaj konvente dhe të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për masat e marra për këtë qëllim.

Neni 2

Njohja e mëmësisë së çdo fëmije të lindur jashtë martese do të bazohet vetëm në faktin e lindjes së fëmijës.

Neni 3

Njohja e atësisë së çdo fëmije të lindur jashtë martese mund të provohet ose përcaktohet nga njohja vullnetare ose me vendim gjykate.

Neni 4

Njohja vullnetare e atësisë nuk mund të kundërshtohet ose të kontestohet për aq sa parashikon ligji i brendshëm për këto procedura, përveç kur personi që kërkon të njohë ose që ka njohur fëmijën nuk është babai biologjik.

Neni 5

Veprimet që lidhen me provat shkencore të përkatësisë së atësisë, që mund të ndihmojnë për të vendosur ose kundërshtuar atësinë, janë të pranueshme.

Neni 6

1. Babai dhe nëna e një fëmije të lindur jashtë martese kanë të njëjtin detyrim për t'u kujdesur për fëmijën sikur të ishte lindur në martesë.

2. Kur detyrimi ligjor për t'u kujdesur për një fëmijë të lindur në martesë bie mbi anëtarë të caktuar të familjes së babait ose nënës, ky detyrim zbatohet gjithashtu në interes të fëmijës së lindur jashtë martese.

Neni 7

1. Kur njohja e një fëmije të lindur jashtë martese është përcaktuar për të dy prindërit, autoriteti prindëror nuk mund t'i atribuohet automatikisht vetëm babait.

2. Ekziston mundësia për të transferuar autoritetin prindëror, rastet e transferimit rregullohen me ligj të brendshëm.

Neni 8

Kur babai apo nëna e një fëmije të lindur jashtë martese nuk ka përgjegjësinë prindërore ose kujdestarinë e fëmijës, ky prind mund të përfitojë të drejtën e aksesit te fëmija në rastet e duhura.

Neni 9

Një fëmijë i lindur jashtë martese ka të njëjtën të drejtë të trashëgimisë në pasurinë e babait dhe nënës së tij dhe të një anëtari të familjes së babait ose nënës të tij, sikur të kishte qenë i lindur në martesë.

Neni 10

Martesa ndërmjet babait dhe nënës së një fëmije të lindur jashtë martese i jep fëmijës statusin ligjor të fëmijës të lindur në martesë.

Neni 11

1. Kjo konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose të miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Kjo konventë hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Në lidhje me një shtet nënshkrues që e ratifikon, e pranon ose e aprovon më pas, konventa hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni 12

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të aderojë në këtë konventë.

2. Ky aderim bëhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të instrumentit të aderimit, i cili hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të tij.

Neni 13

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, specifikon territorin ose territoret, në të cilat zbatohet kjo konventë.

2. Çdo shtet, gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ose në çdo datë të mëvonshme, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë këtë konventë në çdo territor ose territore të tjera të specifikuara në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilave është e autorizuar për të vepruar.

3. Çdo deklaratë e bërë në zbatim të paragrafit të mësipërm, në lidhje me çdo territor të përmendur në këtë deklaratë, mund të tërhiqet në pajtim me procedurat e përcaktuara në nenin 15 të kësaj konvente.

Neni 14

1. Çdo shtet në çastin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ose kur bën një deklaratë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 13 të kësaj konvente, nuk mund të bëjë më shumë se tre rezerva në lidhje me parashikimet e neneve 2 deri 10 të konventës.

Rezerva të natyrës së përgjithshme nuk do të lejohen; çdo rezervë nuk mund të veprojë në më shumë se një dispozitë.

2. Një rezervë do të jetë e vlefshme për pesë vjet nga hyrja në fuqi e kësaj konvente për palën kontraktuese në fjalë. Ajo mund të rinovohet për periudha pasuese për pesë vjet me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës përpara skadimit të çdo periudhe.

3. Çdo palë kontraktuese mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht një rezervë që ka bërë në pajtim me paragrafët e mësipërm me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila hyn në fuqi që nga data e marrjes së saj.

Neni 15

1. Çdo palë kontraktuese, për aq sa është e interesuar, mund të denoncojë këtë konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes të këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 16

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo shtet i cili ka aderuar në këtë konventë për:

a) çdo nënshkrim;

b) çdo depozitim të një instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente në përputhje me nenin 11 të saj;

d) çdo njoftim të marrë në zbatim të parashikimeve të nenit 1;

e) çdo deklaratë të marrë në zbatim të parashikimeve të paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 13;

f) çdo rezervë të bërë në zbatim të parashikimeve të paragrafit 1 të nenit 14;

g) rivendosja e çdo rezerve të kryer në zbatim të parashikimeve të paragrafit 2 të nenit 14;

h) tërheqja e çdo rezerve të kryer në zbatim të parashikimeve të paragrafit 3 të nenit 14;

i) çdo njoftim të marrë në zbatim të parashikimeve të nenit 15 dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Strasburg, më 15 tetor 1975, në anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet kanë të njëjtën fuqi, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara secilit prej shteteve nënshkruese dhe aderuese.

LIGJ
Nr.10 425, datë 2.6.2011

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS "PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e Këshillit të Europës "Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7014, datë 13.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA EUROPIANE
MBI USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE
STRASBURG, 25.1.1996

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese,

duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është të arrijë unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

duke pasur parasysh konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijëve dhe në veçanti, neni nr.4, i cili i kërkon shteteve palë të marrin të gjitha masat e duhura legjislative, administrative dhe të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura në këtë konventë;

duke vërejtur përmbajtjen e rekomandimit 1121 (1990) të Asamblesë Parlamentare mbi të drejtat e fëmijëve;

të bindur se të drejtat dhe interesat më të mira të fëmijëve duhet të promovohen dhe për këtë qëllim fëmijët duhet të kenë mundësinë të ushtrojnë të drejtat e tyre, në veçanti në procedurat familjare që ndikojnë tek ata;

duke konfirmuar se fëmijëve duhet t'u sigurohet informacion përkatës për të mundësuar promovimin e këtyre të drejtave dhe interesave më të mira dhe që pikëpamjeve të fëmijëve duhet t'u jepet rëndësia e duhur;

duke njohur rëndësinë e rolit të prindërve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave më të mira të fëmijëve dhe duke pasur parasysh se, kur është e nevojshme, shtetet duhet të angazhohen në një mbrojtje dhe promovim të tillë;

duke pasur parasysh, megjithatë, se në rast të konfliktit është e dëshirueshme për familjet që të përpiqen të arrijnë një marrëveshje para se ta paraqesin çështjen para një autoriteti gjyqësor,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I
FUSHA E VEPRIMIT, OBJEKTI I KONVENTËS DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1
Fusha e veprimit dhe objekti i konventës

1. Kjo konventë zbatohet për fëmijët që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç.

2. Objekti i kësaj konvente është, në interesat më të mira të fëmijëve, që të promovojë të drejtat e tyre, t'u japë atyre të drejta procedurale dhe të lehtësojë ushtrimin e këtyre të drejtave, duke siguruar që fëmijët, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, të informohen dhe të lejohen për të marrë pjesë në procedime që ndikojnë tek ata para një autoriteti gjyqësor.

3. Për qëllime të kësaj konvente, procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë fëmijët janë procedimet familjare, në veçanti ato që përfshijnë ushtrimin e përgjegjësive prindërore, si vendbanimi dhe aksesi te fëmijët.

4. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, përcakton të paktën tri kategori të çështjeve familjare para një autoriteti gjyqësor, për të cilat duhet të zbatohet kjo konventë.

5. Çdo palë, me anë të një deklaratë të mëtejshme, mund të përcaktojë kategori shtesë të çështjeve familjare për të cilën duhet të zbatohet kjo konventë ose të japë informacion në lidhje me zbatimin e nenit 5, paragrafi 2 të nenit 9, paragrafin 2 të nenit 10 dhe nenin 11.

6. Asgjë në këtë konventë nuk pengon palët që të zbatojnë rregulla më të favorshme për promovimin dhe ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj konvente:

a) termi "autoritet gjyqësor" nënkupton një gjykatë ose autoritet administrativ që ka kompetenca të barasvlershme;

b) termi "mbajtësit e përgjegjësive prindërore" nënkupton prindërit dhe persona të tjerë ose organe, të cilët kanë të drejtë të ushtrojnë disa ose të gjitha përgjegjësitë prindërore;

c) termi "përfaqësues" nënkupton një person, si për shembull një avokat apo organ i caktuar për të vepruar para një autoriteti gjyqësor në emër të një fëmije;

d) termi "informacion përkatës" nënkupton një informacion që është i përshtatshëm për moshën dhe arsyetimin e fëmijës dhe që do të jepet për t'i mundësuar fëmijës të ushtrojë plotësisht të drejtat e tij apo të saj, përveçse kur dhënia e këtij informacioni është në kundërshtim me mirëqenien e fëmijës.

KREU II

MASAT PROCEDURALE PËR TË PROMOVUAR USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

A. TË DREJTAT PROCEDURALE TË FËMIJËVE

Neni 3

E drejta për t'u informuar dhe për të shprehur pikëpamjet e tij ose të saj në procedim

Një fëmijë, që sipas ligjit të brendshëm konsiderohet se ka arsyetim të mjaftueshëm, në rast të procedimeve para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ai/ajo, i jepet dhe ka të drejtë të kërkojë të drejtat e mëposhtme:

a) të marrë të gjithë informacionin përkatës;

b) të konsultohet dhe të shprehë pikëpamjet e tij ose të saj;

c) të informohet për pasojat e mundshme të përputhshmërisë me këto pikëpamje dhe pasojat e mundshme të çdo vendimi.

Neni 4

E drejta për të aplikuar për emërimin e një përfaqësuesi të veçantë

1. Në bazë të nenit 9, fëmija ka të drejtë të kërkojë, personalisht ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, një përfaqësues të posaçëm në procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë te fëmija, ku ligji i brendshëm përjashton mbajtësit e përgjegjësive prindërore nga përfaqësimi i fëmijës si rezultat i konfliktit të interesit me këtë të fundit.

2. Shtetet janë të lira të kufizojnë të drejtën në paragrafin 1, të fëmijëve të cilët sipas ligjit të brendshëm, konsiderohen se kanë arsyetim të mjaftueshëm.

Neni 5

Të drejta të tjera të mundshme procedurale

Palët shqyrtojnë mundësinë e dhënies së të drejtave procedurale shtesë fëmijëve në lidhje me procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ata, në veçanti:

a) të drejtën që të kërkojnë ndihmë nga një person i përshtatshëm i zgjedhur prej tyre, me qëllim që t'i ndihmojë ata për të shprehur pikëpamjet e tyre;

b) të drejtën që të kërkojnë vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, emërimin e një përfaqësuesi të veçantë, në raste të caktuara, një avokat;

c) të drejtën për të emëruar përfaqësuesit e tyre;

d) të drejtën për të ushtruar disa ose të gjitha të drejtat e palëve në këtë procedim.

B. ROLI I AUTORITETEVE GJYQËSORE

Neni 6
Procesi i vendimmarrjes

Në procedimet që ndikojnë te fëmija, para se të marrë një vendim, autoriteti gjyqësor:

a) shqyrton nëse ka informacione të mjaftueshme në dispozicion, me qëllim që të marrë një vendim në interesat më të mira të fëmijës dhe, kur është e nevojshme, të marrë informacione të mëtejshme, në veçanti nga mbajtësit e përgjegjësive prindërore;

b) në rastin kur fëmija, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet të ketë arsyetim të mjaftueshëm:

- garanton që fëmija ka marrë të gjithë informacionin përkatës;
- këshillohet me fëmijën drejtpërdrejt në raste të caktuara, nëse është e nevojshme privatisht, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, në një mënyrë që përshtatet me arsyetimin e tij ose të saj, nëse kjo do të ishte haptazi në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës;
- lejon fëmijën të shprehë pikëpamjet e tij ose të saj;

c) i jep rëndësinë e duhur pikëpamjeve të shprehura nga fëmija.

Neni 7
Detyrimi për të vepruar shpejt

Në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor vepron shpejt për të shmangur çdo vonesë të panevojshme dhe vihen në dispozicion procedura për të garantuar që vendimet e tij të zbatohen me shpejtësi. Në raste urgjente, sipas rastit, autoriteti gjyqësor ka kompetencën për të marrë vendime, të cilat janë menjëherë të zbatueshme.

Neni 8
Detyrimi për të vetëvepruar

Në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor ka kompetencën për të vepruar sipas kërkesës së vet, në rastet e përcaktuara nga ligji i brendshëm, kur mirëqenia e një fëmije është në rrezik serioz.

Neni 9
Emërimi i një përfaqësuesi

1. Në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, ku sipas ligjit të brendshëm mbajtësit e përgjegjësive prindërore përjashtohen nga përfaqësimi i fëmijës, si rezultat i një konflikti interesi ndërmjet tyre dhe fëmijës, autoriteti gjyqësor ka kompetencën për të caktuar një përfaqësues të posaçëm për fëmijën në këto procedime.

2. Palët veprojnë me kusht që, në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor do të ketë kompetencën për të caktuar një përfaqësues të veçantë, në raste të caktuara, një avokat për të përfaqësuar fëmijën.

C. ROLI I PËRFAQËSUESVE

Neni 10

1. Në rastin e procedimeve para një autoriteti gjyqësor që ndikon te një fëmijë, përveç nëse kjo do të ishte haptazi në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës, përfaqësuesi:

a) siguron të gjithë informacionin përkatës për fëmijën, nëse fëmija, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet se ka arsyetim të mjaftueshëm;

b) jep shpjegime për fëmijën nëse fëmija, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet se ka arsyetim të mjaftueshëm në lidhje me pasojat e mundshme të përputhshmërisë me pikëpamjet e tij ose të saj dhe pasojat e mundshme të ndonjë veprimi nga ana e përfaqësuesit;

c) përcakton pikëpamjet e fëmijës dhe ia paraqet këto pikëpamje autoritetit gjyqësor.

2. Palët shqyrtojnë shtrirjen e dispozitave të paragrafit 1 për mbajtësit e përgjegjësive prindërore.

D. ZGJERIMI I DISPOZITAVE TË CAKTUARA

Neni 11

Palët shqyrtojnë shtrirjen e dispozitave të neneve 3, 4 dhe 9 në procedimet që ndikojnë te fëmijët para organeve të tjera dhe për çështjet që ndikojnë te fëmijët të cilët nuk janë objekt i procedimeve.

E. ORGANET KOMBËTARE

Neni 12

1. Palët nxisin, nëpërmjet organeve që përmbushin, ndër të tjera, funksionet e përcaktuara në paragrafin 2, promovimin dhe ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.

2. Funksionet janë si më poshtë:

a) të bëjnë propozime për të forcuar ligjin në lidhje me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;

b) të japin mendime në lidhje me projektlegjislacionin mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;

c) të sigurojnë informacione të përgjithshme në lidhje me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve në media, publik dhe personave e organeve që merren me çështje që lidhen me fëmijët;

d) të kërkojnë pikëpamjet e fëmijëve dhe t'i pajisin ata me informacione përkatëse.

F. ÇËSHTJE TË TJERA

Neni 13
Ndërmjetësimi ose proceset e tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Me qëllim parandalimin ose zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo shmangien e procedimeve para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë te fëmijët, palët inkurajojnë ofrimin e ndërmjetësimit ose proceseve të tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përdorimin e këtyre proceseve për të arritur marrëveshje në rastet e caktuara që duhet të përcaktohen nga palët.

Neni 14
Ndihma dhe këshillimi ligjor

Kur ligji i brendshëm parashikon ndihmë apo këshillim ligjor për përfaqësimin e fëmijëve në procedime para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ata, këto dispozita zbatohen në lidhje me çështjet e mbuluara nga nenet 4 dhe 9.

Neni 15
Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ndërkombëtare

Kjo konventë nuk kufizon aplikimin e çdo instrumenti tjetër ndërkombëtar që merret me çështjet e veçanta, të cilat dalin në kontekstin e mbrojtjes së fëmijëve dhe familjeve, dhe në të cilin një palë e kësaj konvente është ose bëhet palë.

KREU III
KOMITETI I PËRHERSHËM

Neni 16
Themelimi dhe funksionet e Komitetit të Përhershëm

1. Komiteti i Përhershëm është ngritur për qëllimet e kësaj konvente.

2. Komiteti i Përhershëm mban nën shqyrtim problemet në lidhje me këtë konventë. Ai në veçanti:

a) mund të shqyrtojë ndonjë çështje të rëndësishme që lidhet me interpretimin ose zbatimin e konventës. Konkluzionet e Komitetit të Përhershëm në lidhje me zbatimin e konventës mund të marrin formën e një rekomandimi; rekomandimet miratohen me një shumicë prej tre të katërtat e votave;

b) mund të propozojë amendamente të konventës dhe të shqyrtojë ato të propozuara në përputhje me nenin 20;

c) mund të ofrojë këshillim dhe ndihmë ndaj organeve kombëtare që funksionojnë në bazë të paragrafit 2 të nenit 12 dhe nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar midis tyre.

Neni 17
Përbërja

1. Çdo palë mund të përfaqësohet në Komitetin e Përhershëm nga një ose më shumë delegatë. Çdo palë ka një votë.

2. Çdo shtet i përmendur në nenin 21, i cili nuk është palë në këtë konventë, mund të përfaqësohet në Komisionin e Përhershëm nga një vëzhgues. E njëjta gjë vlen edhe për ndonjë shtet tjetër ose të Komunitetit Europian, pasi të jetë ftuar për të aderuar në konventë në përputhje me dispozitat e nenit 22.

3. Nëse një palë nuk ka informuar Sekretarin e Përgjithshëm për kundërshtimin e saj, të paktën një muaj para mbledhjes, Komiteti i Përhershëm mund të ftojë sa më poshtë për të marrë pjesë si vëzhgues në të gjitha takimet e tij ose në një takim apo pjesë të një takimi:

- cilindo shtet që nuk është përmendur në paragrafin 2 më lart;
- Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
- Komunitetin Europian;
- ndonjë organ ndërkombëtar qeveritar;
- ndonjë organ ndërkombëtar joqeveritar me një ose më shumë funksione të përmendura në paragrafin 2 të nenit 12;
- ndonjë organ kombëtar qeveritar ose joqeveritar me një ose me shumë funksione të përmendura në paragrafin 2 të nenit 12;
- Komiteti i Përhershëm mund të shkëmbejë informacion me organizatat përkatëse që merren me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.

Neni 18
Takimet

1. Në fund të vitit të tretë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj konvente dhe me nismën e vet, në çdo kohë, pas kësaj date, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të ftojë Komisionin e Përhershëm për t'u takuar.

2. Vendimet mund të merren vetëm në Komisionin e Përhershëm nëse të paktën gjysma e palëve janë të pranishme.

3. Sipas neneve 16 dhe 20, vendimet e Komitetit të Përhershëm do të merren nga shumica e anëtarëve të pranishëm.

4. Në bazë të dispozitave të kësaj konvente, Komiteti i Përhershëm harton rregullat e veta të procedurës dhe rregullat e procedurës të ndonjë pale pune që mund të jetë ngritur për të kryer të gjitha detyrat e caktuara sipas konventës.

Neni 19
Raportet e Komisionit të Përhershëm

Pas çdo takimi, Komiteti i Përhershëm i përcjell palëve dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës një raport mbi diskutimet e tij dhe çdo vendim të marrë.

KREU IV
AMENDAMENTET E KONVENTËS

Neni 20

1. Çdo ndryshim në nenet e kësaj konvente i propozuar nga një palë ose nga Komiteti i Përhershëm i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe përcillet nga ai apo ajo, të paktën dy muaj para takimit të ardhshëm të Komitetit të Përhershëm, për shtetet anëtare të Këshillit të Europës, çdo nënshkrues, çdo palë, çdo shtet të ftuar për të nënshkruar këtë konventë në përputhje me dispozitat e nenit 21 dhe çdo shtet apo komunitet europian, ftohen për të aderuar në të në përputhje me dispozitat e nenin 22.

2. Çdo ndryshim i propozuar në përputhje me dispozitat e paragrafit të mësipërm shqyrtohet nga Komiteti i Përhershëm, i cili dorëzon tekstin e miratuar me një shumicë prej tre të katërtat e votave të hedhura të Komitetit të Ministrave për miratim. Pas miratimit të tij, ky tekst i përcillet palëve për pranim.

3. Çdo ndryshim hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të periudhës prej një muaji pas datës në të cilën të gjitha palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se ata e kanë pranuar atë.

KREU V
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 21
Nënshkrimi, ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në përpunimin e saj.

2. Kjo konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose të miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Kjo konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën tre shtete, duke përfshirë të paktën dy shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me konventën në përputhje me dispozitat e paragrafit të mësipërm.

4. Në lidhje me çdo nënshkrues që shpreh më pas pëlqimin e tij për t'u lidhur me të, konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 22
Shtetet joanëtare dhe Komuniteti Europian

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, me nismën e vet ose me propozim të Komitetit të Përhershëm dhe pas konsultimit të palëve, fton çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, i cili nuk ka marrë pjesë në hartimin e konventës, si dhe Komitetin Europian për të aderuar në këtë konventë me një vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20, nënparagrafi (d) të Statutit të Këshillit të Europës, dhe me votim unanim të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese të autorizuar për të marrë pjesë në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues ose Komunitetin Europian, konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 23
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat zbatohet kjo konventë.

2. Çdo palë, në çdo datë të mëvonshme, me një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund ta shtrijë zbatimin e kësaj konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilit ajo është e autorizuar për të vepruar. Për sa i përket këtij territori, konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit, pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, mund të tërhiqet nga një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 24
Rezervat

Në konventë nuk mund të bëhet asnjë rezervë.

Neni 25
Denoncimet

1. Çdo palë mund të denoncojë në çdo kohë këtë konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 26
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit, çdo nënshkrues, çdo palë dhe çdo shtet tjetër ose Komunitetin Europian që është ftuar të aderojë në këtë konventë për:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente në përputhje me nenet 21 ose 22;

d) çdo ndryshim të miratuar në përputhje me nenin 20, dhe datën në të cilën ky amendament hyn në fuqi;

e) çdo deklaratë të bërë sipas dispozitave të neneve 1 dhe 23;

f) çdo denoncim të bërë në zbatim të dispozitave të nenit 25;

g) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim në lidhje me këtë konventë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Strasburg, më 25 janar 1996, në gjuhën angleze dhe frënge ku të dyja tekstet janë njëlloj të barasvlershme, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara secilit prej shteteve

anëtare të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj konvente, Komunitetit Europian dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë konventë.

LIGJ
Nr.10 426, datë 2.6.2011

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË TRETË SHTESË TË KONVENTËS EUROPIANE "PËR EKSTRADIMIN"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli i tretë shtesë i konventës europiane "Për ekstradimin".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7015, datë 13.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLLI I TRETË SHTESË
I KONVENTËS EUROPIANE MBI EKSTRADIMIN
(Strasburg, 10. 11.2010)

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij protokolli, duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është të arrijë një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

me dëshirën e forcimit të aftësisë së tyre individuale dhe kolektive për t'iu përgjigjur krimit;

duke respektuar dispozitat e konventës europiane mbi ekstradimin (ETS nr.24) e hapur për nënshkrim në Paris më 13 dhjetor 1957 (më poshtë referuar si "konventa"), si dhe të dy protokollet shtesë të saj (ETS nr.86 dhe nr.98), bërë në Strasburg më 15 tetor 1975 dhe më 17 mars 1978, respektivisht;

duke e konsideruar të përshtatshëm plotësimin e konventës në disa aspekte për të lehtësuar dhe përshpejtuar procedurën e ekstradimit kur personi i kërkuar jep pëlqimin për ekstradimin,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Detyrimi për të ekstraduar me procedurë të thjeshtuar

Palët kontraktuese marrin përsipër të ekstradojnë te njëri-tjetri me procedurë të thjeshtuar siç parashikohet nga ky protokoll, personat e kërkuar në përputhje me nenin 1 të konventës, duke iu nënshtruar pëlqimit të këtyre personave dhe marrëveshjes së palës së kërkuar.

Neni 2
Fillimi i procedurës

1. Kur personi i kërkuar është subjekt i një kërkese për arrest të përkohshëm, në përputhje me nenin 16 të konventës, ekstradimi i përmendur në nenin 1 të këtij protokolli nuk është subjekt i paraqitjes së një kërkese për ekstradim dhe të dokumenteve mbështetëse në përputhje me nenin 12 të konventës. Informacioni i mëposhtëm që sigurohet nga pala kërkuese konsiderohet i përshtatshëm nga pala e kërkuar me qëllim zbatimin e neneve 3 deri 5 të këtij protokolli dhe marrjen e vendimit të formës së prerë për ekstradimin me procedurë të thjeshtuar: a) identiteti i personit të kërkuar, duke përfshirë kombësinë ose kombësitë e tij, kur disponohen; b) autoriteti që kërkon arrestin; c) ekzistenca e një urdhër-arresti ose dokumenti tjetër që ka të njëjtin efekt ligjor apo të një vendimi të zbatueshëm, si dhe një konfirmim që personi është i kërkuar në përputhje me nenin 1 të konventës; d) lloji dhe përshkrimi ligjor i veprës, duke përfshirë dënimin maksimal ose dënimin e dhënë në vendimin e formës së prerë, duke përfshirë edhe nëse ndonjë pjesë e vendimit është ekzekutuar; e) informacioni në lidhje me kalimin e kohës dhe ndërprerjen e tij; f) përshkrimi i rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, duke përfshirë kohën, vendin dhe shkallën e përfshirjes së personit të kërkuar; g) pasojat e veprës penale, për aq sa është e mundur; h) në rastet kur kërkohet ekstradimi për zbatimin e një vendimi të formës së prerë, nëse vendimi është dhënë në mungesë.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, mund të kërkohet informacion shtesë në qoftë se informacioni i dhënë në paragrafin në fjalë është i pamjaftueshëm për t'i lejuar palës së kërkuar të vendosë mbi ekstradimin.

3. Në rastet kur pala e kërkuar ka marrë një kërkesë për ekstradim në përputhje me nenin 12 të konventës, ky protokoll do të zbatojë *mutatis mutandis*.

Neni 3
Detyrimi për të informuar personin

Kur një person i kërkuar për qëllime të ekstradimit është arrestuar në përputhje me nenin 16 të konventës, autoriteti kompetent i palës së kërkuar e informon atë person, në përputhje me ligjin e tij dhe pa vonesë të panevojshme, për kërkesën që lidhet me të dhe për mundësinë e zbatimit të procedurave të thjeshtuara të ekstradimit në përputhje me këtë protokoll.

Neni 4
Pëlqimi për ekstradim

1. Pëlqimi i personit të kërkuar dhe, nëse është e përshtatshme, heqja dorë e tij shprehimisht nga e drejta për rregullin e specialitetit jepet para autoritetit gjyqësor kompetent të palës së kërkuar në përputhje me ligjin e kësaj pale.

2. Çdo palë miraton masat e nevojshme për të siguruar që pëlqimi dhe kur është e përshtatshme, heqja dorë, siç referohet në paragrafin 1, përcaktohen në mënyrë të tillë që të tregojnë se personi në fjalë i ka shprehur ato vullnetarisht dhe me vetëdije të plotë për pasojat ligjore. Për këtë qëllim, personi i kërkuar ka të drejtën për një avokat ligjor. Nëse është e nevojshme, pala e kërkuar siguron që personi i kërkuar të ketë ndihmën e një përkthyesi.

3. Pëlqimi dhe, kur është e përshtatshme, heqja dorë, siç referohet në paragrafin 1, regjistrohen në përputhje me ligjin e palës së kërkuar.

4. Sipas paragrafit 5, pëlqimi dhe, kur është e përshtatshme, heqja dorë, siç referohet në paragrafin 1, nuk anulohet.

5. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ose në çdo kohë të mëvonshme, mund të deklarojë se pëlqimi dhe kur është e nevojshme heqja dorë nga e drejta e rregullit të specialitetit, mund të anulohet. Pëlqimi mund të anulohet derisa pala e kërkuar të marrë vendimin e formës së prerë për ekstradimin sipas procedurës së thjeshtuar. Në këtë rast, periudha ndërmjet njoftimit të pëlqimit dhe atij të anulimit të tij nuk merret në konsideratë në përcaktimin e periudhave të parashikuara në nenin 16, paragrafi 4 i

konventës. Heqja dorë nga e drejta e rregullit të specialitetit mund të anulohet deri në dorëzimin e personit në fjalë. Çdo anulim i pëlqimit për ekstradim ose të heqjes dorë nga e drejta e rregullit të specialitetit regjistrohet në përputhje me ligjin e palës së kërkuar dhe i njoftohet palës kërkuese menjëherë.

Neni 5
Heqja dorë nga e drejta e rregullit të specialitetit

Secili shtet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ose në çdo kohë të mëvonshme, mund të deklarojë se rregullat e përcaktuara në nenin 14 të konventës nuk zbatohen kur personi i ekstraduar nga ky shtet, në përputhje me nenin 4 të këtij protokolli:

a) jep pëlqimin për ekstradim; ose

b) jep pëlqimin për ekstradim dhe shprehimisht heq dorë nga e drejta e tij për rregullin e specialitetit.

Neni 6
Njoftime në rast të arrestit të përkohshëm

1. Në mënyrë që pala kërkuese të mund të paraqesë, kur është e zbatueshme, një kërkesë për ekstradim, në përputhje me nenin 12 të konventës, pala e kërkuar bën njoftimin e saj, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se dhjetë ditë pas datës së arrestit të përkohshëm, pavarësisht nëse personi i kërkuar ka dhënë ose jo pëlqimin e tij për ekstradim.

2. Në raste të veçanta, kur pala e kërkuar vendos të mos zbatojë procedurën e thjeshtuar, pavarësisht nga pëlqimi i personit të kërkuar, ajo njofton paraprakisht për këtë palën kërkuese, në mënyrë që të lejojë këtë të fundit të paraqesë një kërkesë për ekstradim para mbarimit të afatit kohor 40-ditor të përcaktuar sipas nenit 16 të konventës.

Neni 7
Njoftimi i vendimit

Kur personi i kërkuar ka dhënë pëlqimin e tij për ekstradim, pala e kërkuar njofton palën kërkuese për vendimin e saj në lidhje me ekstradimin sipas procedurës së thjeshtuar brenda njëzet ditëve nga data në të cilën personi ka dhënë pëlqimin.

Neni 8
Mjetet e komunikimit

Për qëllime të këtij protokolli, komunikimet mund të përcillen nëpërmjet mjeteve elektronike ose çdo mjeti tjetër që ofron prova shkresore, sipas kushteve që i lejojnë palët të vërtetojnë autenticitetin e tyre, si edhe nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol). Në çdo rast, palët e interesuara, me kërkesë dhe në çdo kohë, paraqesin dokumentet origjinale ose kopje të vërtetuara të dokumenteve.

Neni 9
Dorëzimi i personit që do të ekstradohet

Dorëzimi kryhet sa më shpejt të jetë e mundur, dhe mundësisht brenda dhjetë ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ekstradimit.

Neni 10

Pëlqimi i dhënë pas mbarimit të afatit të përcaktuar në nenin 6

Kur personi i kërkuar ka dhënë pëlqimin e tij pas mbarimit të afatit dhjetëditor të përcaktuar në nenin 6, paragrafi 1 i këtij protokolli, pala e kërkuar zbaton procedurën e thjeshtuar siç parashikohet në këtë protokoll nëse nuk ka marrë ende një kërkesë për ekstradim brenda kuptimit të nenit 12 të konventës.

Neni 11

Transiti

Në rast të transitit sipas kushteve të përcaktuara në nenin 21 të konventës, kur një person ekstradohet sipas një procedure të thjeshtuar te pala kërkuese, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) kërkesa për transit përmban informacionin e kërkuar në nenin 2, paragrafi 1 të këtij protokolli;

b) pala që kërkohet të lejojë transitin mund të kërkojë informacion shtesë nëse informacioni i dhënë në nënparagrafin (a) është i pamjaftueshëm për palën në fjalë për të vendosur për transitin.

Neni 12

Marrëdhëniet me konventën dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare

1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë protokoll duhet të interpretohen brenda kuptimit të konventës. Përsa u përket palëve të këtij protokolli, dispozitat e konventës zbatohen *mutatis mutandis*, në masën që ato janë në përputhje me dispozitat e këtij protokolli.

2. Dispozitat e këtij protokolli nuk cenojnë zbatimin e nenit 28, paragrafi 2 dhe 3 i konventës në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet konventës dhe marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Neni 13

Zgjidhjet miqësore

Komiteti Europian për problemet e krimit të Këshillit Europian mbahet i informuar në lidhje me zbatimin e këtij protokolli dhe bën çdo gjë që është e nevojshme për të lehtësuar një zgjidhje miqësore të çdo vështirësie që mund të lindë nga interpretimi dhe zbatimi.

Neni 14

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, të cilat janë palë ose kanë nënshkruar konventën. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Një nënshkrues nuk mund të ratifikojë, pranojë ose miratojë këtë protokoll përveç kur ka ratifikuar, pranuar ose miratuar paraprakisht konventën, apo e bën këtë në të njëjtën kohë. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky protokoll hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Në lidhje me çdo shtet nënshkrues që depoziton më pas instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, ky protokoll hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së depozitimit.

Neni 15
Aderimi

1. Çdo shtet joanëtar që ka aderuar në konventë mund të aderojë në këtë protokoll, pasi ajo të ketë hyrë në fuqi.

2. Ky aderim kryhet duke depozituar një instrument aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Në lidhje me çdo shtet aderues, protokolli hyn në fuqi në datën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit.

Neni 16
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat zbatohet ky protokoll.

2. Çdo shtet, në çdo kohë të mëvonshme, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e këtij protokolli në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Në lidhje me këtë territor, protokolli hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo territor të përcaktuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe gjashtëmujore pas datës ose marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 17
Deklaratat dhe rezervat

1. Rezervat e bëra nga një shtet për ndonjë dispozitë të konventës ose të dy protokolleve shtesë të saj, zbatohen gjithashtu për këtë protokoll, përveç kur ai shtet deklaron ndryshe në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit. E njëjta gjë zbatohet për çdo deklaratë të bërë në lidhje me ose në bazë të çdo dispozite të konventës ose të dy protokolleve shtesë të saj.

2. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë se ai përfiton nga e drejta për të mos pranuar tërësisht ose pjesërisht nenin 2, paragrafi 1 të këtij protokolli. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet.

3. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ose në çdo kohë të mëvonshme, mund të bëjë deklaratat e parashikuara në nenin 4, paragrafi 5 dhe në nenin 5 të këtij protokolli.

4. Çdo shtet mund të tërheqë, tërësisht ose pjesërisht, një rezervë ose deklaratë që ka bërë në përputhje me këtë protokoll, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila hyn në fuqi që nga data e marrjes së saj.

5. Çdo palë që ka bërë një rezervë ndaj nenit 2, paragrafi 1 i këtij protokolli, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni nuk mund të kërkojë zbatimin e atij paragrafi nga një palë tjetër. Sidoqoftë, nëse rezerva është e pjesshme ose e kushtëzuar, ajo mund të kërkojë zbatimin e atij paragrafi, në masën që ajo vetë e ka pranuar atë.

Neni 18
Denoncimi

1. Çdo palë, për aq sa është e interesuar, mund ta denoncojë këtë protokoll nëpërmjet një njoftimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Denoncimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe gjashtëmujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Denoncimi i konventës automatikisht nënkupton denoncimin e këtij protokolli.

Neni 19
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shtet që ka aderuar në këtë protokoll për:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit, ose aderimit;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij protokolli në përputhje me nenet 14 dhe 15;

d) çdo deklaratë të bërë në përputhje me nenin 4, paragrafi 5, nenin 5, nenin 16 dhe nenin 17, paragrafi 1, dhe çdo tërheqje të një deklarate të tillë;

e) çdo rezervë të bërë në përputhje me nenin 17, paragrafi 2 dhe çdo tërheqje të një rezerve të tillë;

f) çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 18 dhe datën në të cilën hyn në fuqi denoncimi;

g) çdo akt, deklaratë, njoftim ose komunikim tjetër që lidhet me këtë protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Strasburg, këtë ditë të 10-të të nëntorit 2010, në anglisht dhe frëngjisht të dyja tekstet janë njëlloj autentike, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara secilit prej shteteve anëtare të Këshillit të Europës dhe shteteve joanëtare që kanë aderuar në këtë konventë.

LIGJ
Nr.10 427, datë 2.6.2011

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE FINANCIARE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË KUNDREJT FEDERATËS RUSE PËR BALANCAT E LLOGARIVE TË KORPORATËS SHTETËRORE "BANKA E ZHVILLIMIT DHE VEPRIMTARISË EKONOMIKE ME JASHTË (VNESHEKONOMBANK)" TE BANKA E SHTETIT SHQIPTAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse për përmbushjen e detyrimeve financiare të Republikës së Shqipërisë kundrejt Federatës Ruse për balancat e llogarive të korporatës shtetërore "Banka e Zhvillimit dhe Veprimtarisë Ekonomike me Jashtë (Vneshekonombank)" te Banka e Shtetit Shqiptar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7016, datë 13.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE FINANCIARE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË KUNDREJT FEDERATËS RUSE MBI BALANCAT E LLOGARIVE TË KORPORATËS SHTETËRORE "BANKA E ZHVILLIMIT DHE VEPRIMTARISË EKONOMIKE ME JASHTË (VNESHEKONOMBANK)" TE BANKA E SHTETIT SHQIPTAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Federatës Ruse (këtu quhen "palë"), me qëllim forcimin e bashkëpunimit dypalësh dhe të marrëdhënieve miqësore ndërmjet të dy vendeve, kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

1. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje zbatohen për detyrimet financiare të Republikës së Shqipërisë ndaj Federatës Ruse që përfaqëson balancën e përgjithshme të pashlyer në llogaritë e veçanta nr.5, 6A dhe 6B të korporatës shtetërore "Banka e Zhvillimit dhe Veprimtarisë Ekonomike me Jashtë (Vneshekonombank)" (më tutje Vnesheconombank), të hapur në Bankën e Shtetit të Shqipërisë për t'i shërbyer xhiros tregtare dhe operacioneve jotregtare ndërmjet BRSS-së dhe Republikës Popullore të Shqipërisë.

2. Detyrimet e sipërpërmendura janë 1036723,48 rubla sovjetike (këtu quhet "borxhi"). Borxhi konvertohet në dollarë amerikanë me një normë këmbimi prej 1 USD-1 rubël sovjetike. Pas zbatimit të normës së këmbimit të sipërpërmendur, borxhi është 1036723,48 USD.

Neni 2

1. Borxhi do të shlyhet tërësisht nga pala shqiptare në dollarë amerikanë në favor të palës ruse jo më vonë se 30 qershor 2011.

2. Pas pagesës së borxhit sipas këtij neni, detyrimet financiare të palës shqiptare të përmendura në pikën 1 të nenit 1 të kësaj marrëveshjeje konsiderohen tërësisht të përmbushura.

Neni 3

1. Nëse borxhi nuk shlyhet tërësisht deri më 30 qershor 2011, pjesa e mbetur e kësaj shume konsiderohet të jetë në vonesë dhe do të mbartë një interes me normën e Liborit duke shtuar një marzh prej 4 (katër) për qind (këtu quhet "interesi i vonuar"). Interesi i vonuar mblidhet duke filluar nga 1 korrik 2011 deri në datën e shlyerjes së plotë dhe duke përfshirë pjesët në vonesë dhe do të paguhet në dollarë amerikanë.

2. Interesi i vonuar llogaritet mbi bazën e numrit faktik të ditëve që kanë kaluar në një vit 360-ditor.

Neni 4

1. Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë dhe Vnesheconombank janë agjentët e autorizuar të palëve shqiptare dhe ruse përkatësisht për qëllimet e llogaritjeve sipas kësaj marrëveshjeje.

2. Agjentët e autorizuar, jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, bien dakord me shkrim për termat dhe kushtet teknike të llogaritjes sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e njoftimit të fundit me shkrim nga secila palë, që konfirmon përfundimin e procedurave përkatëse të brendshme shtetërore.

Kjo marrëveshje mbetet e vlefshme derisa palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre sipas kësaj marrëveshjeje.

Bërë në Moskë më 31 mars 2011, në dy kopje origjinale, secila në shqip dhe rusisht, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike.

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË
TË SHTETIT PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke u nisur nga misioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit për ushtrimin e kontrollit në subjektet dhe programet publike, për t'i siguruar Kuvendit, grupeve të interesit dhe publikut të gjerë informacion mbi përdorimin e fondeve publike;

Duke njohur vizionin e këtij institucioni për ushtrimin e kontrollit të pavarur, objektiv, të sigurt e të besueshëm mbi subjektet që përdorin fonde publike;

Duke u mbështetur në detyrimet kushtetuese e ligjore, si dhe në objektivat afatmesëm e ata vjetorë të institucionit;

Konstaton se gjatë vitit 2010 Kontrolli i Lartë i Shtetit:

- Ka realizuar objektivat e veprimtarisë kontrolluese, duke e shtrirë atë në një numër më të madh subjektesh e veprimtarish;
- Ka rritur cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë kontrolluese, duke zbatuar me korrektësi rregullat ligjore e nënligjore për kontrollin e cilësisë dhe sistemin e sigurimit të cilësisë;
- Në kontrollet e ushtruara, ka zbatuar e zhvilluar një metodologji bashkëkohore, bazuar në standardet ndërkombëtare të kontrollit, standardet e nxjerra nga institucioni në zbatim të tyre dhe praktikat më të mira të vendeve të tjera;
- Në auditimet financiare, i ka dhënë përparësi vlerësimit dhe përcaktimit të riskut, kurse në auditimet e performancës u ka dhënë përparësi subjekteve e problematikave që lidhen me sektorë të ndryshëm të ekonomisë;
- Ka përmirësuar ndjeshëm veprimtarinë për kontrollin e zbatimit të legjislacionit, evidentimin e hapësirave apo mospërputhjeve të mundshme, duke rritur cilësinë e propozimeve për ndryshime e përmirësime të dispozitave ligjore;
- Ka rekomanduar arkëtimin në Buxhetin e Shtetit të dëmit ekonomik të konstatuar gjatë kontrolleve;
- Ka rritur dobinë e kontrolleve dhe cilësinë e rekomandimeve ndaj personave e subjekteve që kanë kryer shkelje ligjore, duke sjellë rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve për masa organizative, administrative e disiplinore;
- Ka përdorur fondet buxhetore, në përputhje me kuotat e planifikuara, sipas zërave të buxhetit;
- Ka kryer rregullisht trajnimin e punonjësve të institucionit;
- Ka mbajtur marrëdhënie bashkëpunimi institucionale e rezultative me institucionet kombëtare e ndërkombëtare; ka rritur transparencën e komunikimit ndaj Kuvendit, medias dhe gjithë opinionit publik.

Kuvendi kërkon që, për vitin 2011, Kontrolli i Lartë i Shtetit të thellojë më tej përvojën në këto drejtime:

- Përdorimin më gjerësisht të metodologjisë bashkëkohore të kontrollit, mbështetur në standardet ndërkombëtare e praktikat më të mira të vendeve të tjera;
- Zhvillimin e burimeve njerëzore, me synim rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit administrativ, veçanërisht të atij kontrollues;
- Rritjen e cilësisë në kontrollin e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, fondeve të projekteve të financuara nga BE-ja e nga institucionet financiare ndërkombëtare;
- Zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe intensifikimin e trajnimit të punonjësve;
- Harmonizimin e veprimtarisë audituese të kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm dhe rritjen e rolit mbikëqyrës ndaj strukturave të auditimit të brendshëm;
- Konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit;
- Rritjen e bashkëpunimit me organet e drejtësisë për shlyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.

2 qershor 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË PROKURIMEVE
PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur e vlerësuar rolin e Avokatit të Prokurimeve për mbrojtjen e interesave të operatorëve ekonomikë, që ushtrojnë veprimtari në fushat e prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandit publik;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera brenda e jashtë vendit;

Konstaton se gjatë vitit 2010 Avokati i Prokurimeve:

- Ka rritur rolin mbikëqyrës për respektimin nga autoritetet kontraktore të kuadrit ligjor e nënligjor në fushat e prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandit publik;
- Ka rritur më tej efektivitetin e punës monitoruese, bazuar në kritere objektive të përzgjedhjes së procedurave të shqyrtuara, si dhe rritjen e cilësisë së punës e të profesionalizmit të stafit administrativ;
- Ka kryer hetim administrativ të plotë të procedurave të shqyrtuara, duke e shtrirë hetimin jo vetëm në vërtetësinë e pretendimeve të operatorëve ekonomikë, por në të gjithë procedurën e kryer nga autoriteti kontraktor;
- Ka rritur rolin mbështetës ndaj operatorëve ekonomikë, që janë ankuar pranë institucionit;
- Ka rritur numrin dhe ka kryer një hetim gjithëpërfshirës të procedurave të prokurimit, të kryera me nismën e vetë institucionit, duke ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këto procedura dhe rritjen e cilësisë së përzgjedhjes së ofertës fituese;
- Ka rritur cilësinë e rekomandimeve që i ka dërguar Agjencisë së Prokurimit Publik për marrjen e masave shtrënguese ndaj shkeljeve ligjore të konstatuara.

Kuvendi rekomandon që, për vitin 2011, Avokati i Prokurimeve të konsolidojë më tej punën për:

- Rritjen e mëtejshme të cilësisë dhe efektivitetit të punës monitoruese për zbatimin me korrektësi të kërkesave ligjore e nënligjore nga autoritetet kontraktore;

- Përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor, veçanërisht në drejtim të prokurimit elektronik, për të siguruar parandalimin e shkeljeve dhe parregullsive të mundshme dhe respektimin e ligjit;

- Rritjen e bashkëpunimit me Agjencinë e Prokurimit Publik, Komisionin e Prokurimit Publik, Kontrollin e Lartë të Shtetit, dhomat e tregtisë dhe institucionet e tjera kombëtare e ndërkombëtare;

- Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të stafit;

- Rritjen e veprimtarisë ndërgjegjësuese ndaj publikut për rolin dhe rëndësinë e institucionit.

2 qershor 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", ndryshuar me ligjin nr. 9499, datë 3.4.2006.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:

- Rritjes dhe konsolidimit të pozicionit të Autoritetit për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve;

- Nxitjes së konkurrencës së lirë dhe mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet ndërmarrjes së hetimit në tregun e importimit të gazit, komunikimeve elektronike, përpunimit të qumështit, ruajtjes dhe sigurisë fizike, transmetimeve dixhitale, tregut të sigurimeve etj.;

- Plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor, ku veçohet rishikimi i ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës", duke u fokusuar në plotësimin e legjislacionit sekondar në fushën e konkurrencës, në përputhshmëri me aktet legjislative të Bashkimit Europian;

- Rritjes së advokacisë së konkurrencës nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë dhe interaktiv me entet rregullatore e institucionet qendrore;

- Rritjes së bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare për të forcuar rolin e Autoritetit në procesin e integrimit të vendit.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2010 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e nënligjor të institucionit, në përputhje me praktikat e vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian, në veçanti për nxitjen e konsolidimin e instrumentit të ankesës së operatorëve të tregut;

- Përfundimin e hetimeve të nisura, si dhe zgjerimin e thellimin e hetimeve në tregje për të eliminuar deformimet e konkurrencës dhe për të mbrojtur konsumatorët;

- Rritjen e efiçencës së ndërhyrjeve në tregjet ku shfaqen shenjat e kufizimit të konkurrencës, nëpërmjet përsosjes së teknikave investigative;

- Rritjen e forcës kontrolluese dhe parandaluese të institucionit të konkurrencës ndaj ndryshimeve në strukturat e tregjeve të rrjedhura nga transaksionet e shitblerjes së aksioneve;

- Konsolidimin e kapaciteteve administrative dhe përafrimin me standardet e autoriteteve homologe, në mënyrë që të forcohet pavarësia e institucionit;

- Rritjen e kulturës për ligjin dhe politikën kombëtare të konkurrencës, duke promovuar partnershipin dhe bashkëpunimin kryesisht me komunitetin e biznesit;

- Ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm dhe publikut për rëndësinë e konkurrencës dhe rolin e Autoritetit në ruajtjen e saj, si dhe bashkëpunimin me ta në këtë proces.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

- Në dhënien dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për monitorimin e tregut dhe hetimin e praktikave që deformojnë konkurrencën në treg;
- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

2 qershor 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur e vlerësuar rolin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar kontributin e tij në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së këtyre tregjeve;

Duke vlerësuar rolin e këtij autoriteti për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut në përgjithësi një informacion cilësor e profesional mbi këto tregje;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të:

- Rritjes dhe konsolidimit të pozicionit të Autoritetit në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare;
- Përmirësimit të kuadrit ligjor ekzistues, duke reflektuar kështu zhvillimet më të fundit të legjislacionit europian, që rregullojnë sektorin financiar jobankar, në përputhje me planin kombëtar të zbatimit të MSA-së, si dhe duke forcuar rolin e Autoritetit, në kuadër të funksionit të tij rregullues;
- Mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, duke garantuar, në të njëjtën kohë, edhe sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur;
- Përdorimit të elementeve të reja të modelit të mbikëqyrjes me bazë risku, të cilat ndihmojnë në analizimin e gjendjes financiare dhe treguesve të operatorëve financiarë;
- Hartimit të strategjive të kujdesshme, si dhe organizimit të punës së institucionit për të monitoruar, parandaluar dhe reaguar ndaj efekteve negative të krizës së tregjeve globale financiare;
- Projektimit, ndërtimit dhe administrimit të sistemeve informatike për procesimin dhe raportimin e të dhënave, në mbështetje të strategjisë së Autoritetit për përmbushjen e nevojave të mbikëqyrjes së tregut, operatorëve të tij dhe mbrojtjen e konsumatorëve;
- Përmirësimit të punës së Autoritetit dhe produkteve të tij, në veçanti për sa i takon veprimtarisë licencuese, të cilat kanë ndikuar edhe në rritjen e investimeve të huaja direkte në tregjet e sigurimeve.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2010 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e në veçanti atij nënligjor, në zbatim të akteve ligjore të miratuara deri tani, në përputhje me praktikat e vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian;
- Përgatitjen e kuadrit ligjor dhe marrjen e masave organizative, me synim përmirësimin e raportit dëme/prime dhe raportit të shpenzimeve;

- Nxitjen e fushatave edukuese për publikun, që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe integritetit të tregjeve;

- Krijimin e hapësirave të nevojshme, që lehtësojnë hyrjen e investitorëve dhe kapitalit të huaj në tregjet financiare jobankare.

2 qershor 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr.10, datë 12.5.2011

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.804, DATË 22.7.2009 "PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË TROJEVE NË ZONAT INDUSTRIALE, KU USHTROHEN VEPRIMTARI EKONOMIKO-INDUSTRIALE, NË OBJEKTET E NDËRTUARA MBI KËTO TROJE"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.804, datë 22.7.2009 "Për përcaktimin e çmimit të trojeve, në zonat industriale, ku ushtrohen veprimtari ekonomiko-industriale, në objektet e ndërtuara mbi këto troje", Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

UDHËZOJNË:

1. Shitja e trojeve, pronë shtetërore, në zonat industriale, ku ushtrohen veprimtari ekonomiko-industriale, në objektet e ndërtuara mbi to, do të bëhet nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes" dhe legjislacionit në fuqi.

2. Në zbatim të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.804, datë 22.7.2009 "Për përcaktimin e çmimit të trojeve, në zonat industriale, ku ushtrohen veprimtari ekonomiko-industriale, në objektet e ndërtuara mbi këto troje", në rast privatizimi, pagesa e trojeve, pronë shtetërore, në zonat industriale, ku ushtrohet veprimtari ekonomiko-industriale, në objektet e ndërtuara mbi to, do të bëhet 50% me lekë dhe 50% me lekë privatizimi, letra me vlerë apo bono privatizimi.

3. Në zbatim të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.804, datë 22.7.2009 "Për përcaktimin e çmimit të trojeve, në zonat industriale, ku ushtrohen veprimtari ekonomiko-industriale, në objektet e ndërtuara mbi këto troje" për objektet të cilat do t'i nënshtrohen procesit të privatizimit, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore", që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes", komisioni i vlerësimit apo/dhe dega e shoqërisë publike, i kërkon institucionit të prefektit në territorin e të cilit ndodhet objekti, konfirmimin e genplanit për objektin.

4. Zyrat urbanistike të organeve të qeverisjes vendore (bashki/komuna) i konfirmojnë degës së shoqërive publike, nëse trualli që do të shitet, shtrihet në zonën industriale të miratuar me vendim të KRRT-së ose KRRTRSH-së.

5. Në rast se trualli që do të privatizohet, ndodhet në zonën industriale të konfirmuar sipas pikës 4, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike në Ministrinë e Financave autorizon kryerjen e pagesës së këtyre trojeve në raportin e parashikuar në pikën 2, referuar konfirmimit të AKKP-së për çmimin e truallit për metër katror sipas hartës së vlerës së miratuar në bazë të zonës ku shtrihet objekti, deri në momentin që do të miratohet nga Këshilli i Ministrave vlera e truallit industrial.

6. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike në Ministrinë e Financave dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE **Ridvan Bode**	MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS **Nasip Naço**	AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE DREJTORI I PËRGJITHSHËM **Elvis Çefa**

UDHËZIM
Nr.254, datë 10.6.2011

PËR KONSTITUIMIN E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të paragrafit 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 "Për prefekin",

UDHËZOJ:

Prefekti/nënprefekti, për rastet kur ushtron ekskluzivisht kompetencat e prefektit:

- Të marrë të gjitha masat për mbarëvajtjen e konstituimit të organeve të reja të qeverisjes vendore, të dala nga zgjedhjet e datës 8 maj 2011;
- Ngre, brenda datës 13 qershor, një grup pune të drejtuar nga prefekti që të ndjekë dhe mbikëqyrë procesin për konstituimin e organeve të qeverisjes vendore të territorit që mbulon;
- Brenda datës 16 qershor 2011, prefekti/nënprefekti të organizojnë një takim pune, për shpërndarjen dhe punimin e këtij udhëzimi, me të gjithë sekretarët e bashkive/komunave.
- Për konstituimin e organeve të qeverisjes vendore, bazuar sa më sipër, udhëzojnë që përgjithësisht, të ndiqet një procedurë e njësuar pune, si më poshtë:

Masat paraprake për organizimin e mbledhjes

Sekretari i këshillit të bashkisë/komunës, mbështetur në rezultatin e zgjedhjeve të datës 8 maj 2011, ndjek këtë procedurë:

Pasi ka marrë dokumentet, si më poshtë:

- Njoftimin zyrtar nga KQZ-ja për shpërndarjen e mandateve në këshillin përkatës;
- Vendimin e gjykatës përkatëse për vërtetimin e zgjedhjes së kryetarit të bashkisë/komunës;
- Njofton brenda 24 orëve prefektin përkatës dhe koordinon me të për caktimin e datës së mbledhjes së parë të këshillit.
- Nëse ky informacion ka mbërritur më parë te prefekti, ky i fundit thërret menjëherë sekretarin e këshillit përkatës për të koordinuar thirrjen e mbledhjes së këshillit.
- Në përputhje me datën e caktuar me prefektin, njofton kryetarin e zgjedhur të bashkisë/komunës dhe i kërkon atij të paraqitet në mbledhjen e thirrur të këshillit përkatës për të deklaruar vlefshmërinë e mandatit dhe realizuar marrjen e datyrës.
- Njofton me shkrim të gjithë këshilltarët e njësisë përkatëse të mandatuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
- Njofton prefektin, partitë politike që kanë përfaqësues në këshill, mediat lokale për datën, orën, rendin e ditës dhe vendin ku do të zhvillohet mbledhja e parë e këshillit.
- Merr masa për organizimin e mbledhjes së parë të këshillit, duke përcaktuar sipas ligjit rendin e ditës, përgatitjen e njoftimeve, përgatitjen e sallës së mbledhjes.

Rendi i ditës i mbledhjes së parë të këshillit do të jetë:

I. Konstituimi i këshillit dhe zgjedhja e organeve drejtuese e përfaqësuese

1. Konstituim i këshillit

- Zgjedhja e komisionit të mandateve;
- Verifikimi i mandateve dhe miratimi i raportit të komisionit të mandateve;
- Betimi i këshilltarëve.

2. Zgjedhja e kryetarit të këshillit

- Paraqitja dhe prezantim i shkurtër i kandidatëve;
- Zgjedhja e komisionit të votimit, si rregull 3 anëtarë;
- Përgatitja dhe procedurat e votimit;
- Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e kryetarit;

3. Zgjedhja e zëvendëskryetarit/ëve të këshillit

- Miratimi me votim i numrit të zëvendëskryetarëve të këshillit;
- Paraqitja dhe prezantim i shkurtër i kandidatëve;
- Përgatitja dhe procedurat e votimit;
- Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e zëvendëskryetarit/rëve.

II. Deklarimi i vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë dhe ceremonia e marrjes-dorëzimit të detyrës

- Shpallja publike e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë/komunës (Kryetari i këshillit lexon vendimin e gjykatës për vërtetimin e faktit juridik të shpalljes kryetar nga gjykata në juridiksionin në të cilat përfshihet komuna ose bashkia (përkatëse.).

- Betimi i kryetarit bëhet sipas formulës së përcaktuar në nenin 28 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Pas betimit të dy kryetarët: ai që largohet dhe kryetari i zgjedhur, së bashku me prefektin/nënprefektin ose përfaqësues të tij firmosin marrjen në dorëzim të detyrës.

- Në rastet kur në ceremoni marrin pjesë anëtarë të Qeverisë: Kryeministri, ministrat, zëvendësministrat apo të dërguar të tyre, firmosja bëhet edhe nga këta të fundit.

Pjesëmarrja

Mbledhja bëhet e hapur. Pjesëmarrja bëhet sipas ftesave të përmendura më sipër.

Përgatitja e mbledhjes

- Sekretari, mbështetur në listën e këshilltarëve, të shpallur nga KQZ-ja, përcakton këshilltarin më të vjetër në moshë, që do të drejtojnë mbledhjen.

- Në ditën dhe orën e caktuar zhvillohet mbledhja e këshillit.

- Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit të shpallur këshilltarë nga KQZ-ja.

- Nëse kjo shumicë nuk realizohet, pas tri ditësh thirrjet një mbledhje e dytë.

- Nëse edhe në këtë rast nuk realizohet shumica e kërkuar, thirret pas tri ditësh një mbledhje e tretë e nëse edhe në këtë mbledhje nuk sigurohet shumica, këshilli konsiderohet i shpërndarë dhe sekretari njofton zyrtarisht prefektin, duke i paraqitur kopjen e lajmërimit të mbledhjeve dhe procesverbalet e mbajtura në secilën mbledhje të thirrur.

Organizimi i mbledhjes

Në mbledhjen e parë të këshillit do të procedohet si më poshtë:

- Sekretari i këshillit lexon vendimin e KQZ-së, emrat e këshilltarëve që janë shpallur të zgjedhur dhe subjektin politik që përfaqëson secili;

- Prezanton të ftuarit që marrin pjesë;

- Komunikon se, në bazë të nenit 26, pika 5 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", që mbledhja e parë e këshillit drejtohet nga këshilltari më i vjetër.

- Këshilltari drejton mbledhjen deri në zgjedhjen e komisionit të votimeve. Fillimisht ia jep fjalën një këshilltari për çdo parti politike që ka grup këshilltarësh.

- Përshëndet prefekti ose i ngarkuari i institucionit të Prefektit.

- Në rast se në mbledhje kanë marrë pjesë personat e cituar në pikën II, përshëndetja mund të kryhet prej tyre.

Pas kësaj fillohet nga shqyrtimi i pikave të rendit të ditës.

1. Konstituimi i këshillit

- Zgjedhja e komisionit të mandateve. Zgjidhen anëtarët e komisionit të mandateve (minimumi 3 veta, kryetar, sekretar, anëtar), bëhen propozimet dhe me votim të hapur miratohet përbërja e këtij komisioni. Komisioni harton raportin për verifikimin e mandateve të këshilltarëve.

- Komisioni i mandateve lexon raportin e vërtetimit të mandateve, kalohet në miratimin e raportit me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

- Pas votimit dhe miratimit të raportit, këshilli konsiderohet i konstituar kur është vërtetuar mandati i më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

- Bëhet betimi i këshilltarëve, sipas formulës së përcaktuar në nenin 28 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", dhe secili këshilltar nënshkruan formulën e betimit.

- Këshilltari që nuk bën dhe nuk nënshkruar formulën e betimit, konsiderohet se ka dhënë dorëheqjen dhe nuk i jepet mandati.

2. Zgjedhja e kryetarit të këshillit

- Paraqitet dhe bëhet prezantim i shkurtër i kandidatëve.

- Zgjidhet një komision votimi, si rregull 3 anëtarë, një nga këshilli dhe nga një përfaqësues për çdo kandidat për kryetar. Nëse numri i komisionit pas kryerjes së procedurave më sipër del çift, këshilli shton edhe një anëtar.

- Komisioni i votimit drejton të gjitha procedurat deri në shpalljen e kryetarit, plotëson fletëvotimet dhe përcakton rregullat e votimit.

- Votimi bëhet i fshehtë dhe pas votimit hartohet procesverbali nga komisioni dhe shpallet kryetari i zgjedhur.

Konsiderohet i zgjedhur kryetar këshilli kandidati që ka marrë shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit. Në rast kur me votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk fiton shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit, bëhet një votim i dytë.

- Kryetari i zgjedhur merr drejtimin e mbledhjes dhe vazhdon procedurat e mëtejshme për konstituimin e këshillit.

3. Zgjedhja e zëvendëskryetarit/ëve të këshillit

Për këtë funksion zhvillohen procedurat njëlloj si në pikën 2 më sipër.

II. Deklarimi i vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë/komunës

Pas procedurave për betimin e kryetarit dhe marrjen-dorëzimin e detyrës nga kryetari i bashkisë/komunës, sipas pikës II më sipër, kryetari i këshillit mbyll seancën e parë të mbledhjes së këshillit

III. Zgjedhja e përfaqësuesit të këshillit në këshillin e qarkut

- Mbështetur në nenin 50 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", sekretari paraqet shkresën zyrtare të marrë nga prefekti, për numrin e përfaqësuesve të këshillit përkatës në këshillin e qarkut. Në varësi me numrin e përcaktuar nga prefekti, propozohen emrat e këshilltarëve që do të përfaqësojnë këshillin e bashkisë apo komunës në këshillin e qarkut.

- Kalohet në zgjedhjen e këshilltarëve që do të përfaqësojnë këshillin e bashkisë apo komunës në këshillin e qarkut (komisioni i votimit mund të jetë ai që u caktua për kryetarin dhe zëvendëskryetarin).

- Plotësohen fletët e votimit. Votimi bëhet, si në çdo rast, i fshehtë dhe në fund komisioni i votimit lexon procesverbalin ku shpallet këshilltari apo këshilltarët e zgjedhur si përfaqësues në këshillin e qarkut.

Çdo përfaqësues në këshillin e qarkut duhet të fitojë shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit. Nëse kjo nuk arrihet me votimin e parë, bëhet një votim i dytë për dy kandidatët që kanë fituar më shumë vota në votimin e parë.

Njoftimi i institucioneve

Prefekti pas konstituimit njofton me shkrim Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Brendshme dhe të gjitha institucionet shtetërore në nivel kombëtar dhe rajonal për konstituimin e organeve të njësisë vendore, emrin e kryetarit të ri të bashkisë dhe komunës, kryetarit të këshillit, përfaqësuesit/sve të këshillit në këshillin e qarkut.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme për Decentralizimin dhe Integrim dhe prefektët/nënprefektët që mbulojnë territoret përkatëse.

Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet Zëvendësministri i Brendshëm.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

VENDIM
Nr.19, datë 1.6.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i “	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i “	“
Vitore Tusha	Anëtare	e “	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i “	“
Sokol Berberi	Anëtar	i “	“
Admir Thanza	Anëtar	i “	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e “	“
Vladimir Kristo	Anëtar	i “	“

me sekretare Blerina Çinari, më datë 4.11.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 21/6 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI : Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën, i paragrafëve VII dhe VIII të nenit 34 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, shqyrtoi pretendimet e kërkuesit: prapësimet e subjekteve të interesuara: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) dhe Këshilli i Ministrave (KM) që janë shprehur për rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me vendimin nr.324, datë 6.3.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës ka deklaruar fajtor shtetasin E.S., për kryerjen e veprës penale të “mosparaqitjes në repart”, parashikuar nga neni 36/1 i Kodit Penal Ushtarak, dhe e ka dënuar atë me 14 000 (katërmbëdhjetë mijë) lekë gjobë. Gjoba duhej paguar nga i dënuari brenda datës 16.9.2009.

Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 18.3.2009.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës ka dërguar në Zyrën e Përmbarimit Gjyqësor të Lushnjës urdhrin e ekzekutimit të datës 18.3.2009, për zbatimin e vendimit penal nr.324, datë 6.3.2009 të lartpërmendur.

Zyra e Përmbarimit Gjyqësor të Lushnjës i ka dërguar njoftim shtetasit E.S. për ekzekutimin vullnetar të detyrimit. Si pasojë e mosshlyerjes së këtij detyrimi nga i dënuari, kjo zyrë ka filluar procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit prej 14 000 lekësh.

Zyra e Përmbarimit Gjyqësor të Lushnjës, pasi ka kryer të gjitha procedurat për ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë, ka konstatuar insolvabilitetin e shtetasit E.S. Në këto kushte kjo Zyrë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të urdhrit të datës 18.3.2009 të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, bazuar në nenin 34/7 të Kodit Penal (KP) dhe në nenin 467/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i është drejtuar gjykatës për konvertimin e dënimit prej 14 000 lekësh, dhënë me vendimin nr.324, datë 6.3.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, ndaj shtetasit E.S. në dy ditë burgim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës (Gjykata referuese), me vendimin nr.415 akti, datë 20.5.2010 ka vendosur pezullimin e gjykimit të kërkesës penale nr.415 akti, me objekt konvertimin në ditë burgimi të dënimit penal me gjobë të dhënë ndaj të gjykuarit E.S. dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për t'u shprehur nëse paragrafët VII dhe VIII të nenit 34 KP-së, të cilët parashikojnë zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim, janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

II

Gjykata referuese pretendon se dispozitat e sipërcituara bien në kundërshtim me nenin 27 të Kushtetutës, pasi në këtë rast kufizimi i lirisë së shtetasve kryhet për shkaqe, të cilat nuk janë të përfshira në këtë dispozitë kushtetuese, e cila duke qenë taksative, është edhe shteruese për sa u përket shkaqeve kur liria e individit mund të kufizohet në mënyrë të ligjshme nga autoritet shtetërore.

Edhe pse ka *prima facie* një ngjashmëri ndërmjet shkronjës "b" të nenit 27/2 të Kushtetutës, e cila parashikon se liria e personit mund të kufizohet në bazë të një urdhri të gjykatës, në rastin konkret vendimi penal me gjobë nuk mund të interpretohet si një urdhër gjykate në këtë drejtim, pra që synon të kufizojë lirinë e personit.

Gjykata referuese pretendon, gjithashtu, se dispozitat për të cilat kërkohet kontrolli kushtetues, bien në kundërshtim edhe me nenin 18 të Kushtetutës, i cili sanksionon barazinë e shtetasve para ligjit. Nga ana e ligjvënësit nuk janë zbatuar dispozitat e nenit 18/3 të Kushtetutës, i cili lejon diskriminimin e shtetasve për arsye të gjendjes së tyre ekonomike, kur plotësohen këto kushte: Diskriminimi të jetë: a) i ligjshëm; b) i arsyeshëm; dhe c) objektiv. Duke qenë se konvertimi i dënimit diskriminon personat që janë në pamundësi objektive të paguajnë gjobën, duke i vënë këta të fundit në një pozitë të disfavorshme në lidhje me personat që kanë mundësi të paguajnë gjobat penale, Gjykata referuese pretendon se ky lloj disavantazhi është i paarsyeshëm.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, parashtroi:

- Kërkuesi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi plotësohet vetëm njëri nga kushtet që legjitimon gjyqtarët të investojnë këtë Gjykatë, posaçërisht norma e kontestuar ka lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen konkrete dhe nuk plotësohet kushti i dytë, që antikushtetutshmëria e normës të jetë pengesë për zgjidhjen e çështjes konkrete nga gjykata referuese.

- Për themelin e çështjes, pretendimi për cenim të nenit 27 të Kushtetutës nuk qëndron, pasi dënimi i formës së prerë me gjobë përbën një urdhër të dhënë nga gjykata dhe, si i tillë, justifikon dënimin me burg gjatë konvertimit në përputhje me nenin 27/b të Kushtetutës.

- Po ashtu, nuk qëndron pretendimi për cenim të nenit 18 të Kushtetutës, sepse konvertimi i dënimit kryhet pasi vetë shtetasi ka shkelur rregullat dhe zbatimi i ligjit penal është i domosdoshëm. Duke qenë se konvertimi i dënimit është i mirërregulluar nga KP-ja dhe KPP-ja nuk kemi situata paqartësie dhe legjislacioni penal vepron pa shkelur nenin 18 të Kushtetutës.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, parashtroi:

- Konvertimi i dënimit justifikohet nga shkronjat "a" dhe "b" të nenit 27 të Kushtetutës, i cili parashikon se liria mund të kufizohet "për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës, ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj". Ndërsa dënimi me burgim, i dhënë nga gjykata, gjen arsyen e vet në kryerjen e një vepre penale, dënimi me burgim, në bazë të konvertimit të parashikuar në nenin 34/8, gjen mbështetje në moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata. Konvertimi është në përputhje me nenin 27 të Kushtetutës për arsye se, duke qenë se vendimi me burg pas konvertimit jepet nga një gjykatë kompetente, jemi në kushtet e shkronjës "a", e cila parashikon se liria mund t'i kufizohet personit "kur është dënuar me burg nga gjykata kompetente".

- Dënimet me burgim dhe me gjobë janë të barasvlershme në lidhje me riedukimin e autorit të veprës. Dënimi me burgim është implicit në momentin që gjykata përcakton gjykimin me gjobë, duke qenë se dy dënimet janë plotësisht të zëvendësueshëm njëri me tjetrin.

- Pretendimi për cenim të nenit 18 të Kushtetutës nuk qëndron, për arsye se situata më e rëndë për individët që nuk disponojnë mjete monetare, kundrejt personave që kanë më shumë mjete nuk vjen nga veprimi i autoriteteve shtetërore, por është krijuar nga vetë individi me vullnetin e lirë. Dispozitat që parashikojnë konvertimin e dënimit ose caktimin e tij janë hartuar duke pasur parasysh individin si qenie njerëzore dhe duke abstraguar nga cilësitë që individi mund të fitojë gjatë jetës, përfshirë nivelin ekonomik të tij. Neni 34 parashikon mundësinë për një diskriminim pozitiv për shtetasit me të ardhura të pakta dhe jo një diskriminim negativ.

- Shfuqizimi i dispozitave objekt shqyrtimi do të krijonte një situatë edhe teorikisht diskriminuese, pasi shtetasit, që nuk do të ishin insolventë, do të vuanin dënimin penal, kurse ata në pamundësi ekonomike jo, duke krijuar bazat për rritjen e kriminalitetit.

III

Për legjitimimin e kërkuesit

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në përputhje me nenet 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës mund të ushtrojnë kontrollin e kushtetutshmërisë së normës gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore, duke pasur si parakusht që kushtetutshmëria e normës së referuar të jetë *conditio sine qua non* për zgjidhjen e çështjes konkrete.

Gjykata referuese, në përputhje me parimin e drejtësisë efektive, ka për detyrë të shohë në tërësi pozitat procedurale dhe materiale të palëve dhe gjendjen e tyre pas zgjidhjes se çështjes konkrete. Nëse gjykata referuese ka arsye të besojë se zgjidhja e çështjes nga ana e saj mund të çojë në cenimin e të drejtave kushtetuese të shtetasve, atëherë ajo është e autorizuar nga urdhërimi i normës kushtetuese që të referojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, për zgjidhjen e problemit të kushtetutshmërisë.

Në rastin konkret, gjykata referuese ka konstatuar se konvertimi i dënimit me gjobë në dënim me burgim mund të sjellë diskriminimin e të dënuarit për arsye të gjendjes së tij ekonomike, si dhe mund të cenojë lirinë e tij jashtë kushteve të parashikuara në nenin 27 të Kushtetutës.

Gjykata çmon se një konstatim i tillë nga ana e gjykatës referuese ngre *prima facie* probleme kushtetutshmërie në lidhje me cenimin e parimit të barazisë para ligjit, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, dhe parimit të mosdënimit pa ligj, të parashikuar në nenin 29 të Kushtetutës. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se gjykata referuese legjitimohet në paraqitjen e kërkesës për kontrollin e kushtetutshmërisë së paragrafëve 7 dhe 8 të nenit 34 të KP-së.

IV

Për pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së shtetasve para ligjit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës

Gjykata, para se t'i japë përgjigje pretendimit të gjykatës referuese se dispozita penale, objekt kontrolli kushtetues, i bie ndesh nenit 18 të Kushtetutës, sepse lejon diskriminimin e personave për shkak të gjendjes së tyre ekonomike pa arsye të përligjura, vlerëson të marrë në shqyrtim, fillimisht, funksionin e dënimit penal.

Dënimi penal përmbush dy funksione të ndryshme, të cilat mund të konsiderohen si edukative. Nga njëra anë qëndron funksioni i parandalimit të përgjithshëm të veprave penale, pasi kërcënimi, se shteti do të zbatojë sanksione penale sa herë që shtetasit do të kryejnë veprime të dënueshme nga legjislacioni penal, funksionon si një mënyrë për të dekurajuar dhe parandaluar cilindo nga shtetasit që të ndërmarrë veprime që bien në kundërshtim me normat penale. Nga ana tjetër, qëndron funksioni i parandalimit të posaçëm, i cili lidhet drejtpërsëdrejti me autorin e veprës, pasi duke zbatuar sanksionin penal synohet riedukimi i tij, në mënyrë që pas kryerjes së dënimit të mos ndërmarrë në të ardhmen veprime kriminale.

Gjykata, nisur nga natyra e çështjes në shqyrtim, e shikon të arsyeshme të ndalet kryesisht në parandalimin e posaçëm. Në përputhje me frymën e Kushtetutës, sanksioni penal i cilësdo natyre duhet të synojë vetëm riedukimin dhe më pas integrimin e të dënuarit në jetën shoqërore.

Në këto kushte, Gjykata sheh me vend të analizojë nëse konvertimi i dënimit me gjobë në dënim me burgim, kur autori është në pamundësi për të shlyer gjobën, cenon standardin e barazisë së shtetasve para ligjit dhe, në këtë kuptim, është në përputhje me këtë funksion riedukativ që duhet të luajë sanksioni penal.

Gjykata, duke pasur parasysh dhe doktrinën e konsoliduar europiane në këtë fushë, konstaton se, që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer. Nëse koncepti i lirisë vetjake dhe vetë liria vetjake janë të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme të shtetasit që nga momenti i lindjes së tyre, nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për mjetet financiare që disponon gjithsecili, të cilat janë të shpërndara në mënyrë tejet të ndryshme nga një person te tjetri. Dënimi me gjobë lindi si një mënyrë për të shmangur dënimin me burgim, pasi konsiderohej si më e drejtë që personi të mund të paguante një shumë të hollash për vepra që kishin një rrezikshmëri të ulët shoqërore, pa pasur nevojë që të privohej nga liria. Qëllimi i dënimit me gjobë, në frymën e Kushtetutës, duhet rilexuar në kuptimin që funksioni riedukativ mund të përmbushet edhe nga pagesa e një shume të caktuar, pa qenë nevoja që personi të privohet nga liria vetjake. Në rastin e konvertimit të dënimit me gjobë në atë me burg, duket se ligjvënësi i vendos shtetasit para alternativës që të zgjedhin midis detyrimit për të paguar një shumë të hollash ose të vuajnë dënimin me burgim. Konstatohet lehtë se, nëse një person i caktuar është në pamundësi absolute që të shlyejë detyrimin, ai privohet nga kjo zgjedhje.

Gjykata referuese pretendon se vuajtja e dënimit me burgim nga persona, të cilët janë në pamundësi absolute të shlyejnë detyrimet monetare kundrejt shtetit, diskriminon personat që nuk kanë mundësi financiare kundrejt atyre që i kanë këto mundësi.

Gjykata çmon se procesi i riedukimit, në rastet e personave që do të vuajnë dënimin me burgim, pas konvertimit mund të kompromethohet në mënyrë serioze nëse ky konvertim nuk bëhet në kushte dhe rrethana të përcaktuara shprehimisht në mënyrë të plotë e të gjithanshme në ligj. Në të kundërt, këta persona do ta perceptonin konvertimin si një akt të padrejtë, thjesht për faktin se ata janë në kushte ekonomike më të vështira në raport me shtetasit e tjerë, të cilët, duke i pasur këto kushte mund t'i shpëtojnë dënimit me burgim.

Gjykata konsideron se vetë procesi i konvertimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim, pa hetuar më parë kushtet ekonomike të të dënuarit dhe më pas pamundësinë e pagimit të gjobës, nuk përputhet me frymën e Kushtetutës, pasi dënimi me gjobë është diametralisht i kundërt me atë me burgim dhe çdo konvertim i njëanshëm nuk mund të jetë i përpjesëtuar.

Në mbështetje të këtyre argumenteve mjafton të analizojmë mënyrën sesi caktohet dënimi sipas Kodit tonë Penal. Sipas nenit 47 të këtij Kodi, në caktimin e dënimit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në këtë mënyrë gjykata gjatë dhënies së dënimit vlerëson se cili lloj dënimi është në përpjesëtim me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit të saj. Konvertimi i njëanshëm i dënimit me gjobë, të dhënë nga gjykata, në dënim me burgim, cenon parimin e *favor libertatitis*, sipas të cilit privimi nga liria duhet përdorur si *extrema ratio*.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk mund të ketë një trajtim të njëtrajtshëm të të dy dënimeve. Në interpretimin e Gjykatës, çfarëdolloj transformimi i dënimeve, i kryer duke prezumuar të njëjtën rëndësi kushtetuese të të dyja vlerave, duhet të përjashtohet.

Interpretimi i bërë në parashtrimet e Këshillit të Ministrave, se në rastin e konvertimit kemi të bëjmë thjesht me një transformim, pasi ka një barazi thelbësore mes dënimit me gjobë dhe atij me burgim dhe se dënimi me burgim është implicit në momentin e përcaktimit të dënimit me gjobë, është i gabuar dhe jo në përputhje me frymën dhe përmbajtjen e Kushtetutës. Në shpjegimet e veta, Këshilli i Ministrave ka pretenduar se konvertimi është i domosdoshëm, pasi sanksioni penal duhet zbatuar në çdo rast, në mënyrë që të realizohen efektet e parandalimit të përgjithshëm dhe të posaçëm të përshkruara më sipër.

Gjykata vlerëson se domosdoshmëria e sanksionit penal është një element i patjetërsueshëm i rendit juridik pozitiv, por në këtë rast ky i fundit nuk vihet në diskutim. Ajo që diskutohet, në rastin konkret, është mundësia ose pamundësia për të përmbushur qëllimin e dënimit, riedukimin e të dënuarit, i cili, siç u tha më sipër, është funksion i patjetërsueshëm i dënimit penal. Parashikimi në KP të sanksioneve të dënimit me burgim dhe atij me gjobë, mund të lexohet vetëm si një mënyrë për të balancuar llojet e sanksioneve në vendimmarrjen e gjykatave, në raport me veprimet e jashtëligjshme të individëve, në mënyrë që, krahas ndëshkimit, të realizohet edhe riedukimi i të dënuarit. Në këtë mënyrë, është detyrë e gjykatës që gjatë hetimit gjyqësor të verifikojë gjendjen ekonomike të të pandehurit, me qëllim që të aplikojë dënimin më të përshtatshëm.

Me këtë rast, Gjykata e çmon me vend të analizojë nenet 90, paragrafi i parë, dhe 92 të KP-së. Në këto nene ligjvënësi nuk ka parashikuar dënim me burgim për këto vepra penale dhe, për rrjedhojë, në rastin e konvertimit të dënimit, gjyqtari do të duhej të caktonte një dënim me burgim, i cili është përjashtuar që në fazën e hartimit dhe të miratimit të legjislacionit penal. Në këtë mënyrë mund të dallohen qartë dy momente të ndryshme, në të cilat gjyqtari ka tagra dhe diskrecion të ndryshëm. Nëse gjatë caktimit të dënimit gjyqtari ka tagër të hetojë mbi fajësinë e personit dhe gjendjen e tij vetjake, përfshirë këtu dhe situatën e tij ekonomike, në mënyrë që të zgjedhë dënimin më të përshtatshëm për të mundësuar riedukimin e këtij individi, gjatë konvertimit të dënimit gjyqtari nuk ka asnjë diskrecion, por ai në mënyrë mekanike, thjesht përcakton kohëzgjatjen e burgimit. Pikërisht ky fakt, pra që gjyqtari nuk ka asnjë lloj mundësie që të vendosë në lidhje me përshtatshmërinë e dënimit me burgim, përbën një nga elementet kryesore të jokushtetutshmërisë së normës, e cila, në kundërshtim me frymën e përgjithshme që përmbajnë nenet e sipërpërmendura, për caktimin e dënimit, nuk i lë gjyqtarit asnjë lloj mundësie që të ketë si parametër drejtues në caktimin e dënimit, riedukimin e të dënuarit, përkundrazi cakton një dënim me burgim, i cili as që është parashikuar nga KP-ja.

Gjykata, në mbështetje të argumenteve të saj, vlerëson t'i referohet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese Italiane, konkretisht vendimit nr.131 të vitit 1979, i cili shpallte si antikushtetues konvertimin e dënimeve me gjobë. Me këtë vendim Gjykata Kushtetuese Italiane i hapi rrugë ligjvënësit, që në vitin 1981 të ndërmerrte një reformë në këtë fushë, duke parashikuar dënime alternative ndaj dënimit me burgim, në rastet e mospagimit të gjobave penale, praktikë kjo që u konsiderua në përputhje me Kushtetutën e Republikës Italiane nga Gjykata e sipërpërmendur në vitin 1987 me vendimin nr.108.[1]

Gjykata Kushtetuese Italiane shprehej, ndër të tjera, se në momentin që vetëm për faktin se vërtetohet pamundësia paguese e të dënuarit, duhet të procedohet në fazën ekzekutive në mënyrë të pashmangshme dhe automatike, me konvertimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim, shfaqet një cenim i parimit të barazisë në fushën e së drejtës penale. Sipas kësaj Gjykate, konvertimi paraqet në të vërtetë dhe pa dyshim një rëndim të dënimit të dhënë nga gjyqtari dhe ndryshon për këtë arsye raportin e përpjesëtueshmërisë ndërmjet rëndësisë së veprës dhe fajësisë së të dënuarit nga njëra anë dhe llojit dhe sasisë së dënimit të dhënë nga ana tjetër, i përcaktuar nga gjyqtari në mënyrë

[1] Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka paraqitur gjithashtu, në mbështetje të argumenteve të veta, disa vendime të Gjykatës Kushtetuese Italiane, por rezulton se këto vendime janë më të hershme se vendimet e cituara më sipër nga Gjykata.

diskreciale, sipas parametrave dhe kufizimeve ligjore (*shih vendimin nr.131/1979, të Gjykatës Kushtetuese Italiane*).

Gjykata Kushtetuese Italiane në trajtimin e çështjes, në këtë vendim ka mbajtur parasysh edhe "përvojën e të drejtës së krahasuar" duke iu referuar konkretisht Kodit Penal të Republikës së Gjermanisë.

Duke qenë se subjektet e interesuara kanë pretenduar se konvertimi i dënimit me gjobë, në dënim me burgim, është një praktikë e parashikuar nga legjislacionet e shumë vendeve europiane, përfshirë dhe atë të Gjermanisë, Gjykata e sheh të arsyeshme të analizojë në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e dispozitave të disa prej këtyre vendeve, duke i krahasuar me dispozitat objekt shqyrtimi.

Kodi Penal Gjerman, në seksionin 40, kur bën fjalë për caktimin e dënimit me gjobë, parashikon rregulla të hollësishme që duhet t'i ketë parasysh gjykata, duke filluar nga mënyra e pagimit, me këste ditore, caktimi i tyre nga vetë gjykata në përputhje me të ardhurat mesatare ditore që ka, ose mund të ketë i dënuari, vlerësimin e të ardhurave të tjera, përfshirë asetet dhe rrethana të tjera, me qëllimin e vetëm që gjoba e vendosur të jetë brenda aftësive paguese të të dënuarit.

Ratio legis, e përdorur nga ligjvënësi gjerman, është se, nëse këstet ditore janë llogaritur në mënyrën e duhur nga gjykata, i dënuari nuk e paguan gjobën, pasi me vullnet të lirë ose zgjedh të mos paguajë gjobën, ose po me vullnet të lirë, ose me faj, shpërdoron të ardhurat e veta. Në këtë mënyrë është e pamundur që një person, i cili që *ab initio* ishte në pamundësi paguese, të dënohet me gjobë dhe, për rrjedhojë, të pësojë konvertimin e dënimit nga gjoba në burgim.

Të njëjtën logjikë përdor edhe Kodi Penal Rumun. Sipas nenit 63/1 të këtij Kodi, gjoba penale mund të zëvendësohet me dënimin me burgim vetëm kur konstatohet keqbesimi i të dënuarit në pagimin e gjobës penale. Keqbesimi nuk prezumohet, por duhet të provohet nga organet gjyqësore. Fakti i thjeshtë i mospagimit të gjobës nuk sjell konkluzionin e keqbesimit, për sa kohë nuk ekzistojnë objektivisht edhe rrethana të tjera, që nuk i ngarkohen të pandehurit, të cilat kanë çuar në mosekzekutimin e gjobës së dhënë. Elementi i keqbesimit nga ana e të dënuarit, siç rezulton nga dispozita penale në fjalë, është element kyç.

Gjykata konstaton se ndryshe nga dispozitat e nenit 34 të KP-së të Republikës së Shqipërisë, që e detyrojnë gjyqtarin të bëjë thjesht veprimin mekanik të transformimit të shumës së mbetur pa paguar nga gjoba penale në ditë burgimi, mjafton të ketë një kërkesë të prokurorit, gjyqtarët e këtyre vendeve (si më sipër) kanë diskrecion të gjerë në lidhje me oportunitetin e konvertimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim, duke pasur parasysh se elementet subjektive përbëjnë detyrim të organit procedues për t'i provuar para gjykatës.

Në një pozicion të ngjashëm me dy eksperiencat e paraqitura më lart në trajtimin e kësaj çështjeje është dhe Kodi Penal Francez. Në nenin 135-1 të këtij Kodi përcaktohet se nga ana e gjyqtarit, për shlyerjen e dënimit me gjobë, mund të vendosen edhe këste ditore, për të cilat ai mban parasysh jo vetëm të ardhurat, por edhe shpenzimet e të dënuarit. Veçori e legjislacionit penal francez (ashtu si në Itali) është caktimi i një gjyqtari ekzekutimi që ndjek në vazhdimësi këtë fazë.

Gjykata, për sa më sipër, arrin në përfundimin se neni 34/8 i KP-së ka probleme kushtetutshmërie për shkak të ometimit legjislativ. Legjislacioni nuk ka parashikuar fuqi të plota për gjyqtarin edhe gjatë momentit të konvertimit të dënimit. Në këtë kuptim, neni 3/2 i KPP-së përbën një dispozitë me karakter të përgjithshëm, parashikimet e së cilës nuk mund të anashkalohen në asnjë rast.

Gjykata vlerëson se gjyqtari, gjatë konvertimit, duhet të ketë mundësinë të hetojë në lidhje me shkaqet që kanë çuar në mosshlyerjen e gjobës dhe, çka është më e rëndësishme, duhet të ketë mundësinë të caktojë dënimin më të përshtatshëm për secilin shkelës, në përputhje me funksionin riedukues të sipërpërmendur.

Gjykata vëren se gjyqtari, që bën konvertimin e gjobës, duhet të ketë mundësinë që të caktojë të gjitha llojet e dënimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe, mbi të gjitha, të ketë mundësinë të përdorë masat alternative të dënimit me burgim.

Duke u mbështetur në argumentet e mësipërm, Gjykata vlerëson se dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë janë dënime kryesore dhe në thelb të ndryshëm nga njëri-tjetri dhe se ndikimi i secilit prej tyre mbi të dënuarin, dhe procesin riedukativ ndaj tij, është shumë i ndryshëm. Në këtë kuptim, konvertimi i dënimit me gjobë në dënimin me burgim është në përputhje me funksionin riedukativ të dënimit, kur i dënuari me vullnetin e tij të lirë refuzon t'i bindet vendimit gjyqësor që e detyron të paguajë gjobën. Në të kundërt, konvertimi i dënimit, kur personi është në pamundësi objektive, çka do të thotë se burgimi nuk varet nga ana subjektive e autorit, por nga kushtet ekonomike të të dënuarit, do të shkaktonte një trajtim të diferencuar vetëm në varësi të gjendjes ekonomike, duke sjellë si pasojë cenimin e parimit të barazisë para ligjit, të sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës.

Për sa më sipër pretendimi i gjykatës referuese për antikushtetutshmërinë e paragrafit 8, të nenit 34 të KP-së është i bazuar.

Në lidhje me pretendimin e gjykatës referuese për antikushtetutshmërinë e paragrafit 7 të nenit 34 të KP-së, Gjykata vlerëson se këto përcaktime janë dispozita të përgjithshme që kanë të bëjnë me mënyrën e shlyerjes së dënimit me gjobë dhe nuk kanë lidhje me çështjen konkrete, dhe për rrjedhojë, nuk mund të jenë objekt i këtij shqyrtimi.

Në lidhje me pretendimin e gjykatës referuese për cenim të nenit 27 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se vendimi për konvertimin jepet nga një gjykatë kompetente për gjykimin e çështjeve penale dhe, për rrjedhojë, në përputhje me dispozitat përkatëse të KP-së dhe KPP-ja kemi të bëjmë me një dënim me burgim të dhënë nga një gjykatë kompetente. Në këto kushte edhe ky pretendim rezulton i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja "a"; 134, pika 1, shkronja "d" të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69 dhe 70 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të paragrafit 8 të nenit 34 të Kodit Penal.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

MENDIM I PAKICËS

Jemi kundër mendimit të shumicës për arsyet e mëposhtme:

Shumica ka shfuqizuar paragrafin 8, të nenit 34 të KP-së, duke arsyetuar si vijon: "Nëse gjatë caktimit të dënimit gjyqtari ka tagër të hetojë mbi fajësinë e personit dhe gjendjen e tij personale, përfshirë këtu dhe situatën e tij ekonomike, në mënyrë që të zgjedhë dënimin më të përshtatshëm për të mundësuar riedukimin e këtij individi, gjatë konvertimit të dënimit gjyqtari nuk ka asnjë diskrecion, por ai në mënyrë mekanike, thjesht përcakton kohëzgjatjen e burgimit. Pikërisht ky fakt, pra që gjyqtari nuk ka asnjë lloj mundësie që të vendosë në lidhje me përshtatshmërinë e dënimit me burgim, përbën një nga elementet kryesore të jokushtetutshmërisë së normës, e cila në kundërshtim me frymën e përgjithshme që përmbajnë nenet e sipërpërmendura, në lidhje me caktimin e dënimit, nuk i lë gjyqtarit asnjë lloj mundësie që të ketë si parametër drejtues në caktimin e dënimit, riedukimin e të dënuarit, përkundrazi aplikon një dënim me burgim, i cili as që është parashikuar nga KP-ja."

Më tej shumica arsyeton edhe se: "…. neni 34/8 i KP-së ka probleme kushtetutshmërie për shkak të ometimit legjislativ. Legjislacioni nuk ka parashikuar fuqi të plota për gjyqtarin edhe gjatë momentit të konvertimit të dënimit. Në këtë kuptim, neni 3/2 i KPP-së përbën një dispozitë me karakter të përgjithshëm, parashikimet e së cilës nuk mund të anashkalohen në asnjë rast. Gjykata vlerëson se gjyqtari, gjatë konvertimit, duhet të ketë mundësinë të hetojë në lidhje me shkaqet që kanë çuar në mosshlyerjen e gjobës dhe, çka është më e rëndësishme, duhet të ketë mundësinë të caktojë dënimin më të përshtatshëm për secilin shkelës, në përputhje me funksionin riedukues të sipërpërmendur. Gjykata vëren se gjyqtari, që bën konvertimin e gjobës, duhet të ketë mundësinë që të caktojë të gjitha llojet e dënimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe, mbi të gjitha, të ketë mundësinë të përdorë masat alternative të dënimit me burgim."

Sipas shumicës, gjyqtari në fazën e konvertimit të dënimit privohet nga mundësia për të vlerësuar llojin dhe masën e dënimit që duhet të aplikojë, pasi i dënuari nuk ka shlyer gjobën e vendosur në gjykimin në themel, për shkak të boshllëkut legjislativ.

Jemi të mendimit se një interpretim i tillë bie në kundërshtim me frymën e neneve 47, 58 dhe vijues të KP-së dhe 467 të KPP-së.

Në interpretim të nenit 467/2 të KPP-së, *pamundësia e marrjes së gjobës* është një fakt që legjitimon prokurorin për të kërkuar konvertimin e dënimit dhe që i nënshtrohet hetimit gjyqësor. Sipas këtij rregulli procedural, prokurori, në këtë gjykim, duhet të provojë fakte që kanë të bëjnë me pamundësinë e marrjes së gjobës. Pamundësia e marrjes së gjobës është rrjedhojë e veprimeve me keqbesim të të dënuarit, apo e paaftësisë paguese të tij për shkak të insolvabilitetit, por në asnjë rast nuk ka të bëjë me mosveprimin e organit kompetent (zyrës së përmbarimit) për të vjelë gjobën, pasi kjo prezumohet. Në kuptim të këtij neni, kompetenca e gjykatës për të analizuar shkaqet e *pamundësisë për marrjen e gjobës,* nuk vihet në dyshim dhe nuk kufizohet vetëm në evidentimin e faktit të mosshlyerjes së gjobës tërësisht apo pjesërisht.

Gjithashtu, nenet 58 dhe vijues të KP-së, në fakt, përcaktojnë se gjykata fillimisht jep një vendim, i cili mund të shkojë deri në 5 vjet burgim dhe më pas vendos që të aplikojë një nga alternativat e dënimit me burgim. Pra gjykata në fillim përcakton një masë dënimi që mund të shkojë deri në 5 vjet burgim dhe më pas aplikon vendosjen në provë të të dënuarit. Që dispozitat i referohen një dënimi konkret të dhënë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe jo masës së dënimit të parashikuar nga dispozitat e KP-së, kuptohet nga interpretimi literal i nenit 59 të KP-së, i cili përcakton se: "… gjykata kur jep një dënim deri në pesë vjet……", pra kuptohet qartë se bëhet fjalë për një dënim specifik të dhënë nga gjykata dhe jo për përcaktimin teorik të bërë në dispozitat e KP-së.

Për sa më sipër, gjykatat nuk kanë asnjë pengesë që në zbatim të dispozitave të sipërpërmendura të KP-së dhe KPP-së të kryejnë veprime në radhën e mëposhtme kronolgjike:

1. Të përcaktojnë shkaqet, për të cilat i dënuari është në pamundësi për pagimin e gjobës.
2. Të përcaktojnë masën e dënimit me burgim sipas nenit 34 të KP-së.
3. Në rast të pamundësisë paguese, për shkak të insovabilitetit, të aplikojnë një nga masat alternative të dënimit me burgim.

Jemi të këtij mendimi pasi nuk ka asnjë ndryshim ndërmjet caktimit të dënimit në gjykimin e themelit dhe më pas aplikimin e një mase alternative dhe caktimit të dënimit pas konvertimit të dënimit me gjobë dhe zbatimit të një mase alternative kur gjykata ka konkluduar pamundësinë paguese për shkak të insovabilitetit të të dënuarit. Si rrjedhim, gjykatat nuk kanë asnjë pengesë konkrete nga ana e legjislacionit material apo procedural, që në rastin e konvertimit të dënimeve penale me gjobë, të aplikojnë nenet 58 e vijues të KP-së.

Qëllimi riedukativ i dënimit penal është një element thelbësor i këtij dënimi dhe si i tillë duhet të mbahet parasysh nga gjykata gjatë cilësdo situatë që ka të bëjë me përcaktimin e një dënimi, qoftë ky në përfundim të një gjykimi në themel, qoftë në fazën e konvertimit të dënimeve penale me gjobë.

Anëtare: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

VENDIM
Nr.39, datë 25.5.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR EKSPORT–IMPORTET E KARTËMONEDHAVE E TË MONEDHAVE METALIKE SHQIPTARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 34 dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për eksport-importet e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.83, datë 7.11.2001 "Për miratimin e rregullores "Për eksport-importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike shqiptare", shfuqizohet.
3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
5. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR EKSPORT–IMPORTET E KARTËMONEDHAVE DHE TË MONEDHAVE METALIKE SHQIPTARE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i sasisë dhe i procedurave për eksport–importin e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare, me ose pa kurs ligjor.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore miratohet në bazë dhe për zbatim të nenit 34 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 3
Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
a) "Monedhë" janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike shqiptare me ose pa kurs ligjor.
b) "Monedhë me "kurs ligjor"" janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike të emetuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat nuk janë tërhequr nga qarkullimi dhe që shërbejnë si mjet pagese e pranohen për të gjitha pagesat e detyrimeve që individët ose subjektet e ndryshme, private ose publike, kryejnë me njëri-tjetrin.

c) “Monedhë pa “kurs ligjor”” janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike shqiptare, të cilat janë tërhequr nga qarkullimi dhe që nuk mund të shërbejnë si mjet pagese për pagesat e detyrimeve që individët ose subjektet e ndryshme, private ose publike, kryejnë me njëri-tjetrin.

d) “*Cash*” është gjendja fizike e monedhave, që eksportohen dhe importohen fizikisht në territorin e Republikës së Shqipërisë.

e) “Eksport” është nxjerrja në *cash*, nga territori i Republikës së Shqipërisë, e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike shqiptare, me ose pa kurs ligjor.

f) “Import” është futja në *cash*, në territorin e Republikës së Shqipërisë, e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike shqiptare, me ose pa kurs ligjor.

g) “Person” është çdo person juridik, sipas kuptimit që i jep neni 26 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

h) “Individ” kupton çdo shtetas, shqiptar ose të huaj, rezident ose jorezident në Republikën e Shqipërisë.

i) “Veprimtari numizmatike” është mbajtja e kartëmonedhave ose monedhave metalike me ose pa kurs ligjor, për qëllime koleksionimi dhe/ose studimi.

KREU II
IMPORTI DHE EKSPORTI I MONEDHAVE

Neni 4
E drejta ekskluzive

Importi *cash* i monedhave shqiptare me kurs ligjor, është e drejtë ekskluzive e Bankës së Shqipërisë.

Neni 5
Import–eksporti nga individët

Çdo individ ka të drejtë të eksportojë ose të importojë në *cash* monedha shqiptare me kurs ligjor nga/në territorin e Republikës së Shqipërisë jo më tepër se shuma prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

Neni 6
Import–eksporti nga personat juridikë

1. Personat juridikë lejohen të eksportojnë monedha shqiptare me kurs ligjor jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë, vetëm për veprimtari numizmatike dhe për adoptim, dhe testim të makinerive dhe sistemeve përpunuese, arkëtuese dhe të livrimit automatik të kartëmonedhës e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, eksporti i monedhave shqiptare nga personat juridikë bëhet vetëm pas dhënies së autorizimit me shkrim nga Banka e Shqipërisë.

3. Banka e Shqipërisë vlerëson dhe vendos për sasinë e monedhave që do të eksportohen, duke u bazuar në kërkesën e personit juridik që kërkon të eksportojë. Kërkesa duhet të përmbajë sasinë që kërkohet të eksportohet, si dhe arsyet e eksportimit.

4. Autorizimi sipas pikës 2 të këtij neni, lëshohet nga administratori përkatës, bazuar në relacionin e përgatitur nga Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë. Në çdo rast, autorizimi përmban gjithashtu edhe sasinë e monedhave që lejohet të eksportohet.

5. Në rastet e eksportit të monedhave për qëllime të adoptimit dhe të testimit të makinave dhe sistemeve përpunuese, arkëtuese dhe të livrimit automatik, shuma e eksportuar duhet të rikthehet në Shqipëri brenda 3 muajve nga data e nxjerrjes së saj. Personi i autorizuar për eksportin e kësaj shume është i detyruar të njoftojë Bankën e Shqipërisë për rikthimin e saj, duke paraqitur dokumentacionin doganor vërtetues.

6. Në rast mosrikthimi të kësaj shume, personi i cili është autorizuar për eksportin e monedhave, humbet të drejtën për të eksportuar monedha në raste të tjera.

Neni 7

Individët dhe personat juridikë mund të eksportojnë dhe të importojnë monedha shqiptare pa kurs ligjor, pa asnjë kufizim.

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 8
Shfuqizime

Rregullorja "Për eksport – importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike shqiptare", e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.83, datë 7.11.2001, shfuqizohet.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	328 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 14.6.2011
Doli nga shtypi më 14.6.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë